AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Bachelor në: "Menaxhim Biznesi"**

**ofruar nga:**

**Kolegji Universitar "LOGOS"**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof. Asoc Jonida Teta**

**Dr. Alba Skendaj**

**Shkurt 2024**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**

**Bachelor në "Menaxhim Biznesi"**

| | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL Aplikues: | Kolegji Universitar "Logos" |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Menaxhimit |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Bachelor në "Menaxhim Biznesi" |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit | UMASH Nr 1 datë 06.01.2011 |
| 5 | Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë | VBA Nr. 47, datë 05.007.2019 |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | Urdhër QSHA. Nr. 18 date 01.03.2022 |
| 7 | Cikli i studimit: | Ckli i parë |
| 8 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 3 vite |
| 9 | Kreditet në total (ECTS): | 180 ECTS |
| 10 | Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/): | Me kohë të plotë |
| 11 | Gjuha (shqip/tjetër): | Gjuha Shqipe |
| 12 | Programi ofrohet nga institucioni | PO |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve | Niveli 6 (gjashtë) |
| 17 | Numri i studentëve | 57 Studentë |
| 18 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | Staf për vitin 2019-2020: PAE 18/12 PAK<br>vitin 2020-2021: PAE 13/10 PAK<br>Vitin 2021-2022: PAE 14/ 10 PAK |

**PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Kolegji Universitar "LOGOS' ka nisur aktivitetin e tij si një institucion privat, jofitimprurës në vitin 2009, ky Institut shndërrohet në Shkollën e Lartë Private "Logos", bazuar në VKM Nr. 1055, dt. 29.7.2009, në përbërje të të cilit ishin dy Fakultete: Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Fakulteti Ekonomik. Programi i studimit në Bsc Menaxhim Biznes në Kolegjin Universitar "Logos" (fillimisht SH.L.P "Logos") është licensuar bazuar në Urdhrin Nr.1 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, dt. 06.01.2011, akredituar me Vendimin e Këshillit të Akreditimit Nr. 338, dt 8.6.2012, të shpallur me Urdhrin e Ministrit të Arsimit e Shkencës Nr. 282, dt. 04.07.2012. Ai është riakreituar me vendim të bordit të Akreditimit nr.47, datë 05.07.2019 me kohëzgjatje tre vite akademike, në nivelin e diplomës 6 sipas Kornizës Shqipare të Kualifikimeve i ofruar nga njësia bazë: Departamenti i Manaxhim Biznesi.

Programi Bachelor në Administrim Biznes është i organizuar në tre vite akademike me kohë të plotë dhe ofron 180 kredite.

Ky program ofron oportunitetin e për studime dhe kualifikime të mëtejshme në përputhje me ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë në Shqipëri. Rregullorja e programit të studimit të Ciklit të Parë "Bachelor" në Menaxhim Biznesi, në Fakultetin Ekonomik e Kolegjit Universitar "Logos" mbështetet në:

- Ligjin nr.80, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";
- VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionete arsimit të lartë".
- Udhëzimin nr. 15, datë 04.04.2008 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës "Për organizimin e studimeve në institucionet e arsimit të lartë";
- Urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës nr. 134 datë 21.03.2011 "Për miratimin e standardeve shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të studimit të ciklit të parë të institucioneve të arsimit të lartë";
- Në Udhëzimin dhe Manualin për Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe të programeve të studimit nga APAAL,
- Statutin e Kolegjit Universitar "Logos";
- Rregulloren e Përgjithshme të Kolegjit Universitar "Logos".
- Rregulloren e Fakultetit dhe Departamentit.

**PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

ASCAL, bazuar në "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017", ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Institucioni, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: **Prof. As. Jonida Teta** dhe **Dr. Alba Skendaj.** Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Rajna Lila.

Vlerësimi i jashtëm i këtij programi studimi është përgatitur nga një grup ekspertësh të kontraktuar nga ASCAL. Për hartimin e këtij raportit u përdorën një sërë dokumentash të vëna në dispozicion nga institucioni. Vec raportit të vlerësimit të brendshëm dhe dokumentave mbështetës të sjella nga IAL në Dosjen e Vetëvlerësimit për të zhvilluar këtë raport grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) u bazua edhe në vizitën dy ditore të zhvilluar në institucion. Në këtë raport u përdorën dhe një sërë dokumentash të tjera dhe informacione të nxjerrë nga takimet dhe intervistat që u kryen gjatë vizitës në institucion, si për shembull me drejtues të departamentit, personelin akademik dhe studentët, përfaqësues të Zyrës së Standardeve dhe Cilësisë, etj.

Për hartimin e raportit GVJ u bazua në kriteret e vendosura në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Standardet e Cilësisë të aprovuara në Kodin e Cilësisë, si dhe aktet ligjore e nënligjore përkatëse. Metodologjia e ndjekur për shkrimin e këtij raporti është analizimi i dokumentave dhe rishikimi i kritereve e kërkesave ligjore në lidhje me akreditimin e programeve të studimit të nivelit "Bachelor" në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri.

Vizitat në institucion u kryen në dataën 11 Tetor 2022. Në ldihje me vizitat dhe takimet e realizuara GVJ ka mbajtur shënime të cilat janë përdorur për të bërë këtë raport. Vlerësimi i programit u përqëndrua në analizën e përmbajtjes së kurrikulës dhe lëndëve, shpërndarjes së krediteve dhe orëve në lidhje me përputhshmërinë ligjore të tyre. U vlësua gjithashtu literature që përdoret, përshtatshmëria e personelit akademik për lëndët që ligjërojnë, sigurimi i cilësisë, etj.

Institucioni dorëzoi dokumentat dhe evidencat e nevojshme për akreditimin në format elektronik tek ASCAL; gjithashtu, gjatë vizitës së GVJ në institucion u paraqitën evidenca të ndryshme për të mbështetur aplikimin e tyre për akreditimin e programit të studimit të nivelit Bachelor në "Menaxhim Biznesi".

## SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

### I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr 47 datë 05.07.2019 janë:

1. Institucioni të rishikojë planin mësimor të këtij program studimi me qëllim shtimin e lëndëve të karakterit menaxherial dhe formues si dhe përfshirjen në plan të disa lëndëve të rëndësishme si psh: Menaxhim Projekti; Sjellje Organizative; Shkrim Akademik etj;
2. Institucioni të parashikojë në planin mësimor të këtij program studimi, detyrën e kursit si një nga format e mësimdhënies;
3. Institucioni të sigurojë përputhshmërinë ndërmjet fushës së ekspertizës së stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi dhe lëndëve që ata mbulojnë në këtë program;
4. Institucioni të pasurojë bibliotekën fizike dhe online me titujt të viteve të fundit, për të gjitha disiplinat, por sidomos për lëndët e menaxhimit dhe marketingut;
5. Institucioni të mundësojë digjitalizimin e të dhënave të stafit akademik dhe studentëve si dhe ndërtimin e një platforme për informimin e studentëve;

### II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- **Për rekomandimin e parë,** institucioni ka bërë përpjekje për të përmbushur këtë rekomandim duke shtuar në program lëndët:

a. Shkrim Akademik
b. Metoda Kërkimi
c. Menaxhim Operacionesh
d. Sjellje Konsumatore
e. Biznes Ndërkombëtar
f. Etikë Biznesi

Gjithashtu janë ndërruar lëndët:

Ishte:

a. Menaxhim dhe Drejtim Biznesi
b. Menaxhim Biznesi Vogël

Bëhen:

a. Parimet Bazë të menaxhimit
b. Sipërmarrje dhe Menaxhim të SME

c. Inovacion

d. Lidership

e. Menaxhim Sistemesh Informacioni

f. Komunukum në Biznes/Sociologji/Psikologji Biznesi

g. Sjellje Organizative

h. Strukturë të dhënash

Plani mësimor është pasuruar me lëndë të cilat janë të një karkateri menaxherial, lëndë të cilat ndihmojnë në procese digjitalizuese dhe proceset e rritjes dhe zhvillimit kërkimor shkencor. GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përmbushur plotësisht.**

- **Për rekomandimin e dytë,** institucioni e ka përmbushur këtë rekomandim ku rreth 50% e lëndëve kanë detyra kursi që prej vitit akademik 2019-2020. Detyrat e kursit janë pjesë e veprimtarisë mësimore dhe shprehen me numër kreditesh dhe orësh mësimore dhe pjanë pjesë e syllabuseve të secilës lëndë. GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përmbushur plotësisht.**
- **Për rekomandimin e tretë**, institucioni ka punuar për plotësimin e këtij rekomandimi duke rekrutuar tre lektorë në vitin 2020 si staf efektiv. Lektorët kanë formimin akademik menaxherial dhe markting dhe kanë lektoruar më parë në lëndët përkatëse të formimit që kanë. ka plotësuar të dhënat mbi ecurinë e studentëve në Bsc "Menaxhim Biznesi", Sekretaria Mësimore disponon në formë të shkruar Rregjistrin Themeltar të studentëve, Rregjistrin e arritjeve akademike, Rregjistrin e lëshimit të diplomave, Rregjistrin e grupit mësimor. GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përmbushur plotësisht.**

- **Për rekomandimin e katërt,** institucioni ka shtuar në periudhën 2019-2022, 95 tituj të rinj në bibliotekë. Gjithashtu institucioni ka krijuar akses për stafin dhe studentët e tij në bibliotekat online JSTOR dhe EBSCO si dhe në revistën Monitor. Institucioni gjithashtu ka krijuar aksesin online pa pagesë në bibliotekën online LOGOS. GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përmbushur plotësisht.**

- **Për rekomandimin e pestë,** institucioni ka përmbushur këtë rekomandim nëpërmjet krijimit të aksesit në dy platforma online. Platformat e krijuara dhe në funksion të studentëve dhe stafit janë Edupage dhe Teams. GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përmbushur plotësisht.**

**Më datë 30.11.2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 32/18 Prot, Datë 30.11.203, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlersimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet me shkresë zyrtare Nr. 285/1 Prot, Datë 14.12.2023.**

KOMENTET MBI DRAFT-RAPORTIN PËR PROGRAMIN BACHELOR NË "MENAXHIM BIZNESI"

**GVJ pasi u njoh me komentin e Institucionit mbi Draft- Raportin, sqaron si vijon:**

Komente nga GVB:

Në referim të analizës nga Grupi i vlersimit të jashtëm ndajm, konkretisht në përmbushjen plotësisht, të standarteve të fushave specifike për këtë program studimi, ndajm të njëjtin mendim, ndërsa në plotësimin e Standartit I Pjesërisht, nuk ndajm të njëjtin mendim, pasi dhe fryma tërësore e analizës në Draft Raport për kriteret e këtij standarti, është për plotësimin tërësor të tyre. Gjithashtu konsiderojmë vlerë të shtuar në Draft Raport, konkluzionet në evidentimin e vlerave që duhet të ruhen si edhe rekomandimet për përmirsimin e konsolidimin të programit të studimit Bachelor në "Menaxhim Biznesi".

Komente nga GVJ:

Në përgjigje të shkresës Nr. 285/1, dt. 14.12.2023 se Rektorit te KOLEGJI UNIVERSITAR "LOGOS", Prof. Ilia Ninka, ju bëjmë me dije se Standardi I.2, I.3 dhe I.5, në gjykimin tonë si eksperte të jashtme për hartimin e RVJ konsiderohen të përmbushura kryesisht, ndaj shkalla e përmbushjes së standardeve të Fushes I konsiderohet se përmbushet kryesisht. Komentet dhe sugjerimet tona përkatëse mund ti gjeni në fund të cdo standardi përkatës të vlerësuar përmbushur kryesisht.

Përgëzojmë edhe një herë gjithë stafin e Departamentit të Menaxhimit në Kolegjin Universitar "Logos" për rezultatet e arritura deri më tani me programin e stduimit Bachelor në "Menaxhim Biznesi".

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Menaxhim Biznesi"**

## I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

| **Standardi I.1**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ofron program studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. | Programi i studimit të ciklit Bachelor në Menaxhim Biznesi synon përgatitjen e profesionistëve, që do punojnë në sektorin privat, publik dhe OJF. Strategjia e KU 'Logos' ka në fokus fushat e biznesit, shkencave humane, arsimin, teknlogjine etj, ku oferta akademike përshtatet me objektivt institucionale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Programi Bachelor në Menaxhim Biznes, është strukturuar për të formuar studentë me njohuritë në fushën e ekonomisë kryesisht, si dhe dhënien e njohurive në përputhje me emërtimin e programit. Ky program promovon vlerat kombëtare bazuar në ofertën akademike të sylabuseve që kanë lëndët.<br><br>Në takimin me Dekanin dhe Përgjegjësen e Departamentit, u përforcua mendimi dhe gjykimi që ky program synon investimin e duhur në kapitalin human, që do të kontribuojnë në rritjen ekonomike, zhvillimin e qëndrueshëm dhe inovativ të sipërmarrjeve shqiptare, lidhjen universitet-industri dhe është një kontributor i rëndësishëm në garantimin e një arsimi të lartë cilësor.<br><br>*Shtojca 3. Plani Strategjik i KU 'Logos', 2018-2024.*<br><br>*Shtojca 14. Planet mësimore*<br><br>*Shtojca 19. Syllabuset e lëndëve*<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Ky program studimi është hartuar në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë në Shqipëri. Programi Bachelor në Menaxhim Biznesi i ofruar nga KU 'Logos' synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare. Përzgjedhja e stafit akademik, literaturës mësimore vendase dhe të huaj, plan programet mësimore dhe syllabuset e lëndëve janë në sinkron me ruajtjen e vlerave kombëtare dhe me ecurinë e vlefshme akademike. Harmonizimi i teorisë me nevojat e tregut vendas është bërë e mundur përmes njohurisë dhe aftësisë së staft akademik dhe kompetencës së tyre për t'u përshtatur me rastet studimore, projektet apo mikrotezat e kompanive shqiptare dhe të ekonomisë shqiptare, duke krijuar në këtë mënyrë dhe modelin e konsoliduar të |

| | |
|---|---|
| | Shkollës së Biznesit në Shqipëri. Përforcim i këtij harmonizimi janë dhe aktivitetet jashtëkurrikulare si leksionet e hapura, konferencat studentore dhe shumë aktivitete të tjera.<br><br>*Shtojsc 3. Plani Strategjik i KU 'Logos', 2018-2024.*<br><br>*Shtojca 14. Planet mësimore*<br><br>*Shtojca 19. Syllabuset e lëndëve*<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | GVJ bazuar në RVB dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatoi se program i studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi është hartuar bazuar në strategjinë e KU 'Logos' dhe synon përmbushjen e qëllimeve dhe misionit të institucionit për shpërndarjen e dijes. Në takimin me Dekanin e Fakultetit dhe drejtuesin e departamentit përforcuam mendimin se programi Bachelor në Menaxhim Biznesi është në përputhje të plotë me vizionin e institucionit. Misioni I këtij institucioni fokusohet në zhvillimin e dijeve përmes mësimdhënies dhe mësimnxënies, kërkimin shkencor dhe përmirësimin e vazhdueshëm bazuar në prioritet kombëtare. Vizioni, misioni dhe qëllimet e institucionit theksohen dhe në statutin e KU 'Logos', dhe të gjitha instancat punojnë për arritjen e tyre.<br><br>*Shtojca 2. Statuti i KU 'Logos'*<br><br>*Shtojsc 3. Plani Strategjik i KU 'Logos', 2018-2024.*<br><br>*Shtojca 14. Planet mësimore*<br><br>*Shtojca 19. Syllabuset e lëndëve*<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar. | Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës. Gjatë shqyrtimit të dosjes së plotë të programit të studimit, Syllabuseve të lëndëve dhe Planit Strategjik të Programit, evidentohet që programi është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës në Shqipëri për specialistë me aftësi menaxheriale, për të punuar në SME dhe ndërmarrjet e mëdha shqiptare, në organizatat jofitimprurëse dhe në organizatat e huaja që operojnë në Shqipëri dhe më gjerë.<br><br>Grupi i punës gjatë vizitës u njoh me programet të cilat japin një kontribut në formimin e menaxherëve në sektorët privat dhe publik në fushat dhe industri të ndryshme të cilat operojnë në vend. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *Shtojca 19. Syllabuset e lëndëve*<br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi I.2**<br>**Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit. | Kolegji Univesitar 'Logos' ka 3 Fakultete dhe 9 Njësi bazë, dhe siguron autonominë akademike për secilën strukturë bazë të saj. Programi Bsc në Menaxhim Biznesi, për vetë përmbajtjen e lëndëve që ofronë menaxhohet plotësisht nga Departamenti i Menaxhimit. Në Rregulloren e Departamentit të Menaxhimit paraqiten kompetencat e tij në lidhje me hapjen, riorganizimin, përshtatjen dhe mbylljen e programeve të studimit. Gjithashtu, Departamenti mban përgjegjësi për menaxhimin e përmbajtjes së lëndëve, mënyrën e zhvillimit të tyre, përmirësimin dhe përshtatjen e tyre në kohë.<br>Për të siguruar cilësinë KU 'Logos' ka krijuar struktura si Komisioni I Përhershëm i Garantimit dhe Sigurimit të Cilësisë së Institucionit dhe Programeve të Studimit si dhe Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Departamenti përpilon në mënyrë periodike raporte për ecurine e punës së tij në bashkëpunim me NJSBC. Në Analizën Vjetore të Punës Mësimore, Kërkimore dhe Shkencore Departamentit të Menaxhimit për vitin akademik 2020-2021 gjejmë të analizuar: ngarkesën mësimore dhe një sërë sugjerimesh për përmirësimin e procesit mësimor; analizën e rezultateve të studentëve dhe të mësimdhënies, e cila vjen e detajuar sipas programeve të studimit dhe lëndëve; kërkimin shkencor me disa rubrika nga botimet, në mobilitetet, pjesëmarrjen në projekte ndërkombëtare dhe lokale. Për të bashkërenduar në sigurimin e cilësisë KU 'Logos' ka krijuar një sërë strukturash mbështetëse si Zyra e Cështjeve Studentore, Zyra e shërbimeve e të tjera të cilat mund të aksesohen dhe në faqen zyrtare të institucionit.<br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim* |

| | |
|---|---|
| | *Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'*<br><br>*Shtojca 13. Politika për Sigurimin e Cilësisë*<br><br>*Shtojca 8. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë*<br><br>*Shtojca 60. Organigrama e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 2.** Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit. | Një nga elemetët e rëndësishëm për përmbushjen e vizionit dhe arritjen e objektivave të programit studimor dhe të intitucionit është dhe krijimi i bashkëpunimeve me aktorë të tjerë në arsim dhe biznes, brenda dhe jashtë vendit. Bazuar në dokumentacionin në dispozicion që lidhet me marrëveshjet që intitucioni ka dhe shkëmbimet e studentëve dhe stafit akademik në kuadër të programit ERASMUS, institucioni ka bërë përpjekje për rritjen e partneriteteve dhe lëvizshmërisë, por përsëri ka vend për përmirësim.<br><br>*GVJ rekomandon që departamenti i Menaxhimit duhet ta shfrytëzojë për më shumë bashkëpunime me industrinë. Duhen ndërtuar skemat formale të bashkëpunimit me industrine dhe duhen gjetur rrugë që mundësojnë jo vetëm punësimin e studentëve dhe praktikat/intershipet e tyre, por dhe projektet e përbashkta, mbështetjen e ideve dhe stratupeve të reja, patentim, etj.*<br><br>*Gjithashtu rekomandohet dhe rritja e bashkëpunimeve në kuadër të programit ERASMUS, të cilat do të mundësonin lëvizjen e studentëve dhe stafit akademik.*<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'*<br><br>*Shtojca 13. Politika për Sigurimin e Cilësisë*<br><br>*Shtojca 8. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë*<br><br>*Shtojca 60. Organigrama e KU 'Logos'*<br><br>*Shtojca 63 Informimi i studentëve për Erasmus*<br><br>*Shtojca 34 Marrëveshjete bashkëpunimit active me institucionet Brenda dhe jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe të huaj dhe për praktikën profesionale*<br><br>*Shtojca 65. Raporte Vjetore Institucionale* |
| **Kriteri 3.** Emërtimi, | GVJ konstatoi se në planin mësimor të këtij programi studimi |

| | |
|---|---|
| organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit. | praktika profesionale zë një vend të rëndësishëm, dhe ka qëllim që studenti të zbatojë njohuritë teorike në praktikë, të ketë kontakte me tregun e punës etj. KU 'Logos' ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme dhe me organizata biznesi të cilat shfrytëzohen për praktikat profesionale të studentëve. Bazuar në dokumentacion, por edhe në takimin me studentët gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi se ndjekja dhe realizimi i praktikave të studentëve është i mirë organizuar.<br><br>KU 'Logos' për vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022 ka zhvilluar një sërë aktivtetesh, ka bërë disa publikime në Ëeb, por mbetet shumë më tepër për t'u bërë në bashkëpunim me zvdekanin përkatës për marrëdhëniet me sipërmarrjen dhe departamentin, për të konceptuar dhe ngritur një sistem funksional të bashkëpunimit industri – universitet.<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'*<br><br>*Shtojca 13. Politika për Sigurimin e Cilësisë*<br><br>*Shtojca 8. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë*<br><br>*Shtojca 60. Organigrama e KU 'Logos'*<br><br>*Shtojca 63 Informimi i studentëve për Erasmus*<br><br>*Shtojca 34 Marrëveshjete bashkëpunimit active me institucionet Brenda dhe jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe të huaj dhe për praktikën profesionale*<br><br>*Shtojca 65. Raporte Vjetore Institucionale.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi I.3**<br>**Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, | Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi dhe Rregullorja e Departamentit të Menaxhimit përcaktojnë aftësitë që studentët do të fitojnë në përfundim të këtij program dhe ku do të mund të specializohen studentët në |

| | |
|---|---|
| aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit. | përfundim të këtij cikli studimi.<br><br>Në Dosjen e Plotë të Programit të Studimit, gjejmë të formuluara objektivat formuese të programit, të cilat në thelbin e vet synojnë formimin e profesionistëve të menaxhimit në funksionet kryesore të biznesit dhe të organizatës, thellimin e njohurive të menaxhimit, fuqizimi i të menduarit dhe analizës kritike, përqasja ndaj kreativitetit dhe inovacionit, si dhe përgatitja për një karrierë të suksesshme.<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 2.** Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës. | Institucioni bazuar në dokumentacionin dhe vizitën e grupit të vlerësimit të jashtëm, kryen analiza periodike të studimeve që zhvillojnë institucione dhe organizata në Shqipëri. Për mirëfunksionimin e lidhjes së studentëve me tregun e punës KU 'Logos' ka mgritur Zyrën e Cështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës, ku mbahen të dhënat statistikore për ndjekjen e studentëve pas përfundimit të studimeve.<br><br>Formalizimi i mëtejshëm i marrëdhënieve me biznesin konsiderohet një nga rekomandimet që vlerësuesit e jashtëm kanë për drejtuesit e fakultetit dhe të departamentit, përtej dokumentave të paraqitura në dosjen e akreditimit.<br><br>*Shtojca 17. Studimi për tregun e punës, pas daljes së studentëve.*<br><br>*Shtojca 57. Vlerësim punëdhënësi për ALUMNI*<br><br>*Shtojca 55. Regjistrat e Biznesit 2021*<br><br>*Shtojca 3. Plani Strategjik I KU 'Logos'*<br><br>*Shtojca 56. Vendimi i Senatit Akademik dhe njoftimi në MARS e riorganizimit të njësive bazë.* |
| **Kriteri 3.** Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve. | Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi përmes lëndëve që zhvillon garantojn përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve. Programi mbështetet në eksperienca globale, natyrisht kjo përbën një avantazh, por në takimet me pedagogët dhe drejtuesit e departamentit/fakultetit ata u shprehën që përmes rasteve studimore, projekteve në skuadër, të ftuarve në auditor, vizitave studimore në kompani, praktikave dhe punimeve të diplomave ata mundësojnë lidhjen e kompetencave me nevojat e tregut të punës. |

| | |
|---|---|
| | Programi është përmirësuar bazuar në rekomandimet e mëparshme duke ofruar në këtë mënyrë lëndë të cilat përshtasin studentin me kërkesat e tregut të punës dhe garantojnë fitimin e njohurive të përgjithëshme dhe të karakterit professional.<br><br>Grupi i punës rekomandon të krijohet një përqasje me proaktive të departamentit në lidhje me praktikën e punës së studentëve, punën kërkimore dhe lidhjen me TIK. Një forcim i lidhjes me bizneset do të mundësonte praktikat profesionale, dhe një rritje të lidhjes me Teknologjinë e informacionit do të mundësonte rritjen e aftësive digjitale të studentëve.<br><br>*Shtojca 14. Plani mësimor i programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 3. Plani Strategjik I KU 'Logos'*<br><br>*Shtojca 57. Vlerësim punëdhënësi për ALUMNI*<br><br>*Shtojca 55. Regjistrat e Biznesit 2021* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi I.4**<br>**Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar. | Programi Bsc në Menaxhim Biznesi i ofruar nga Departamenti i Menaxhimit i KU 'Logos' është një ndër programet e para të këtij institucioni dhe mbështetet në këto tre shtylla:<br><br>- Së pari, KU "Logos' ka një përvojë të hershme në fushën e arsimit. Gjithashtu, duhet theksuar që ky program ka patur përmirësime bazuar në rekomandimet e ardhura nga akreditimi.<br><br>- Së dyti, stafi akademik, ku Departamenti i Menaxhimit ka në përbërje të tij 5 pedagogë të brendshëm, të cilët përbejne stafin që mban përgjegjësinë për t'u angazhuar në këtë program dhe 11 pedagogë të tjerë janë staf me kohë të pjesshme.<br><br>Rekomandohet rritja e numrit të stafit efektiv për këtë program studimi.<br><br>- Së treti, infrastruktura, ku Fakulteti Ekonomik ofron mjediset e nevojshme për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve, në godina të konceptuara në mënyrë bashkëkohore dhe me mjetet e |

| | |
|---|---|
| | nevojshme visuale për zhvillimin e mesimit.<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'*<br><br>*Shtojca 20. CV e stafit akademik të programit të studimit* |
| **Kriteri 2.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | Programi Bsc në Menaxhim Biznesi funksionon në përputhje të plotë me Statutin dhe Rregulloren e KU 'Logos', si dhe Rregulloren e Programit të Studimit. Programi i studimit që akreditohet është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të Ekonomisë dhe Departamentit të Menxhimit që është njësia bazë e ofrimit të tij. Ky program është në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe aktet nënligjore në fuqi dhe udhëzimeve kombëtare e europiane. Të gjtiha departamentet e Fakultetit Ekonomik bashkëpunojnë ngushtësisht me njëra tjetrën për arritjen e objektivave të tyre në lidhje me fushat akademike dhe kërkimore.<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 3.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje. | GVJ konstatoi se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Ekonomise, si njësia bazë dhe përgjegjëse për programin e studimit si edhe në përputhje të direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e europiane.<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| Standardi I.5<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | Kolegji Univesitar 'Logos' ka tre fakultete dhe nëntë njësi bazë, dhe siguron autonominë akademike për secilën strukturë bazë të saj. Programi Bsc në Menaxhim Biznesi, për vetë përmbajtjen e lëndëve që ka menaxhohet plotësisht nga Departamenti i Menaxhimit. Në Rregulloren e Departamentit të Menaxhimit paraqiten kompetencat e tij në lidhje me hapjen, riorganizimin, përshtatjen dhe mbylljen e programeve të studimit. Gjithashtu, Departamenti mban përgjegjësi për menaxhimin e përmbajtjes së lëndëve, mënyrën e zhvillimit të tyre, përmirësimin dhe përshtatjen e tyre në kohë.<br><br>Për të siguruar cilësinë KU 'Logos' ka krijuar struktura si Komisioni I Përhershëm i Garantimit dhe Sigurimit të Cilësisë së Institucionit dhe Programeve të Studimit si dhe Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.<br><br>Departamenti përpilon në mënyrë periodike raporte për ecurine e punës së tij në bashkëpunim me NJSBC. Në Analizën Vjetore të Punës Mësimore, Kërkimore dhe Shkencore Departamentit të Menaxhimit për vitin akademik 2020-2021 gjejmë të analizuar: ngarkesën mësimore dhe një sërë sugjerimesh për përmirësimin e procesit mësimor; analizën e rezultateve të studentëve dhe të mësimdhënies, e cila vjen e detajuar sipas programeve të studimit dhe lëndëve; kërkimin shkencor me disa rubrika nga botimet, në mobilitetet, pjesëmarrjen në projekte ndërkombëtare dhe lokale.<br><br>Për të bashkërenduar në sigurimin e cilësisë KU 'Logos' ka krijuar një sërë strukturash mbështetëse si Zyra e Cështjeve Studentore, Zyra e shërbimeve e të tjera të cilat mund të aksesohen dhe në faqen zyrtare të institucionit.<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'*<br><br>*Shtojca 13. Politika për Sigurimin e Cilësisë*<br><br>*Shtojca 8. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë*<br><br>*Shtojca 60. Organigrama e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e | Një nga elemetët e rëndësishëm për përmbushjen e vizionit dhe |

| | |
|---|---|
| objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj. | arritjen e objektivave të programit studimor dhe të intitucionit është dhe krijimi i bashkëpunimeve me aktorë të tjerë në arsim dhe biznes, brenda dhe jashtë vendit. Bazuar në dokumentacionin në dispozicion që lidhet me marrëveshjet që intitucioni ka dhe shkëmbimet e studentëve dhe stafit akademik në kuadër të programit ERASMUS, institucioni ka bërë përpjekje për rritjen e partneriteteve dhe lëvizshmërisë, por përsëri ka vend për përmirësim.<br><br>GVJ rekomandon që departamenti i Menaxhimit duhet të konsiderojë më shumë bashkëpunime/partneritete me industrinë. Duhen ndërtuar skemat formale të bashkëpunimit me industrine dhe duhen gjetur rrugë që mundësojnë jo vetëm punësimin e studentëve dhe praktikat/intershipet e tyre, por dhe projektet e përbashkëta, mbështetjen e ideve dhe stratupeve të reja, patentim, etj. Gjithashtu rekomandohet dhe rritja e bashkëpunimeve në kuadër të programit ERASMUS, të cilat do të mundësonin lëvizjen e studentëve dhe stafit akademik.<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'*<br><br>*Shtojca 13. Politika për Sigurimin e Cilësisë*<br><br>*Shtojca 8. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë*<br><br>*Shtojca 60. Organigrama e KU 'Logos'*<br><br>*Shtojca 63 Informimi i studentëve për Erasmus*<br><br>*Shtojca 34 Marrëveshjete bashkëpunimit active me institucionet Brenda dhe jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe të huaj dhe për praktikën profesionale*<br><br>*Shtojca 65. Raporte Vjetore Institucionale* |
| **Kriteri 3.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve. | Në dokumentacionin e vetëvlerësimit, njësia përgjegjëse kishte të hartuara raporte për përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit. Këto përfitime të analizuara në raportet e përpiluara lidheshin me realizimin optimal të programit të studimit sikurse dhe përfitimet e studentëve prej këtyre bashkëpunimeve.<br><br>*Shtojca 34 Marrëveshjete bashkëpunimit active me institucionet Brenda dhe jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe të huaj dhe për praktikën profesionale* |

| | |
|---|---|
| | *Shtojca 65. Raporte Vjetore Institucionale* |
| **Kriteri 4.** Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë. | Kolegji Universitar 'Logos', në kuadër të praktikave mësimore ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme dhe ka një përpjekje të vazhdueshme për zgjerimin e këtij bashkëpunimi. Gjithashtu institucioni vendos në dispozicion personel për instuktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studemntëve në praktikën profesionale.<br><br>Brenda Fakultetit ka disa eksperienca pozitive në bashkëpunimin me industrinë. Këto praktika të mira do të duhet të funksionalizohen në nivel departamenti, fillimisht dhe më pas në nivel programi.<br><br>*Shtojca 34 Marrëveshjete bashkëpunimit active me institucionet Brenda dhe jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe të huaj dhe për praktikën profesionale*<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit* |
| **Kriteri 5.** Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. | GVJ konstaton se institucioni ofron trajnime profesionale për studentët. Gjithashtu nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, Lista e Marëveshjeve të Bashkëpunimit, evidentojmë që ofrohen prej tyre trajnime ose intership-e.<br>Gjithësesi GVJ rekomandon që të rritet numri i trajnimeve profesionale dhe të bëhet ndjekja e mëtejshme e studentëve në tregun e punës.<br><br>*Shtojca 34 Marrëveshjete bashkëpunimit active me institucionet Brenda dhe jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe të huaj dhe për praktikën profesionale* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR NË MENAXHIM BIZNESI

| **Standardi II.1**<br><br>**Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Programi i studimit përmban lëndë në përputhje me ligjin e arsimit të lartë Nr.80/2015 datë 22.07.2015. Programi i studimit i referohet nivelit të 6 të kornizës së kualifikimeve dhe ofrohen lëndët të ndara në:<br>- Lëndë bazë<br>- Lëndë karakterizuese<br>- Lëndë ndërdisiplinore dhe Lëndë integruese;<br>- Lëndë plotësuese<br>- Detyrime përmbyllëse<br><br>KU 'Logos' ofron programe të studimeve të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Plani mësimor për programin e studimit Bsc në Menaxhim Biznesi pasqyron zhvillimin e programit në tre vite akademike, me 180 kredite, sipas përcaktimeve për programet Bachelor në legjislacionin për arsimin e lartë. Plani përmban informacionet për lëndët/modulet të vlerësuara me kredite sipas sistemit ECTS si dhe siguron një shpërndarje të balancuar të ngarkesës mësimore ndërmjet semestrave.<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 14. Plani mësimor i programit Bsc në Menaxhim Biznesi*<br><br>*Shtojca 19. Syllabuset e lëndëve të programit Bsc në Menaxhim Biznesi.* |
| **Kriteri 2.** Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion GVJ konstatoi se programi i studimit Bsc në Menaxhim Biznesi përmban të dhenat e plota në lidhje me lëndët, format e realizimit të veprimtarive dhë mësimdhënies dhe të gjitha karakteristikave të lëndëve. I njëjti informacion i detajuar gjëndet dhe në syllabuset e lëndëve. Programi dhe lëndët që ai ka, kanë si qëllim përgatitjen e drejtuesve, specialistëve apo pjesëtarëve të stafeve të kompanive private, te institucioneve shtetërore apo |

| | |
|---|---|
| | organizatave jofitimprurëse me një orientim të caktuar.<br><br>Programi i studimit Bsc në Menaxhim Biznesi jep njohuritë e përparuara në fushën e biznesit, menaxhimit, marketingut, menaxhimit të shitjeve, sjelljes konsumatore dhe teknologjisë së informacionit si dhe u mundëson studenteve pajisjen me dije dhe aftësi për të analizuar situata dhe për të zgjidhur probleme nëpërmjet analizës, të kuptuarit kritik dhe vendimarrjeve racionale. Syllabuset e lëndëve të këtij programi përmbajnë njouritë e përparuara dhe për diskutimin, miratimin dhe zbatimin e tyre ndiqet proceduara e miratimit përpara cdo fillimi të vitit akademik. Programi i studimit Bsc në Menaxhim Biznesi ka si qëllim formimin e ekspertëve dhe specialistëve në fushën e administrimit të biznesit dhe sipërmarrjes. Instrumentat e përdorura për ndërtimin dhe pasurimin e kurrikulës bazohen në përvojat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe mundësojnë përmbajtjen e kurrikulave të larmishme që mundësojnë zhvillimin e aftësive të transferueshme që përgatisin studentë për mjedise të ndryshueshme punësimi.<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 14. Plani mësimor i programit Bsc në Menaxhim Biznesi*<br><br>*Shtojca 19. Syllabuset e lëndëve të programit Bsc në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 64. Procesverbal Departamenti i Menaxhimit miratimi i syllabuseve 2021-2022* |
| **Kriteri 3.** Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës. | Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët bazuar në ligjit në fuqi. Kategorizimet e lëndëve të këtij programi janë:<br>1. A-Lëndë bazë: (33 kredite), 18.3%;<br>2. B-Lëndë karakterizuese: (90 kredite), 50%;<br>3. C-Lëndë ndërdisiplinore/integruese: (25.5 kredite), 14.2%;<br>4. D-Lëndë plotësuese: (25.5 kredite), 14.2%;<br>5. E-Detyrime përmbyllese: (6 kredite), 3.3%;<br><br>GVJ evidenton që kategoritë dhe ngarkesat në kreditë të lëndëve dhe moduleve janë në përputhje me Vendimin Nr. 879, datë 18.12.2019.<br><br>*Shtojca Tabela 9. Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive* |

| | |
|---|---|
| | *Formuese (A-E)* |
| **Kriteri 4.** Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | Në Dosjen e Plotë të Programit të Studimit Bsc në Menaxhim Biznesi, më specifikisht pjesët që lidhen me Programin dhe Planin Mësimor të tij, Praktika zë 6 kredite dhe 150 orë mësimore.<br>Praktika mësimore zhvillohet bazuar në syllabus, dhe në mbrojtjen e praktikës, studenti duhet të paraqesë tre dokumenta: Relacion mbi praktikën e zhvilluar, Formularin e Vlerësimit nga pedagogu përgjegjës, Formularin e Vlerësimit nga mbikqyrësi në vendin e zhvillimit të praktikës.<br>***Formaliteti që shoqëron praktikat në çdo IAL është një çështje sensitive e të gjithë sistemit të arsimit të lartë, institucionet ndoshta duhet të mendojnë rrugë dhe zgjidhje në këtë drejtim.***<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 5.** Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore. | Programi i studimit përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e programit sic është përcaktuar nga ligji në përputhje me VKM nr.41 'Për elementët e programeve të studimit t ofruara nga institucionet e arimit të lartë, VKM nr.879 'Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.41 dhe VKM nr.185, duke përcaktuar strukturën e krediteve, orët në auditor, orët jashtë auditorit, studimin e pavarur, sipas viteve dhe semestrave.<br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 6.** Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. | GVJ evidentoi bazuar në dokumentacion se programi i studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi është i vetmi program studimi bachelor që ofrohet në këtë fushë studimi nga njësia përgjegjëse për të Departamenti i Menaxhimit. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

<table>
<tr><td colspan="2">Standardi II.2<br><br>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.</td></tr>
<tr><th>Kriteret</th><th>Vlerësimi i ekspertëve</th></tr>
<tr><td>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</td><td>Njësia bazë dhe përgjegjëse për programin e studimit Bsc në Menaxhim Biznesi është Departamenti i Menaxhimit, i cili i përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. Ky organizim bazohet në vendimin e senatit Akademik nr23. Datë 11.09.2019 dërguar në MARS. Departamenti i Menaxhimit si njësi bazë bashkërendon veprimtarinë mësimore dhe shkencore në fushën e ekonomisë. Departamenti zhvillon të gjithë aktivitetin në përputhje me legjislacionin në fuqi, në përmbushje të gjithë standardeve të cilësisë për mësimdhënie dhe procesin e kërkimit shkencor. Kjo njësi bazë programon, organizon dhe bashkërendon veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore shkencore në disiplinat e ekonomiksit, menaxhimit, marketingut, sipërmarrjes dhe disiplina e lëndë të tjera të ndërlidhura të fushës ekonomike. E gjithë veprimataria e fakultetit dhe njësive bazë të tij mbështetet në rregulloret e vendosura nga KU 'Logos' dhe në rregulloret e njësive përkatëse, në të cilat pasqyrohen misioni dhe objektivat e secilës prej tyre.<br><br>Departamenti i Menaxhimit, eshte përgjegjës për programin e studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi. Njësia bazë është përgjegjëse për planifikimin, organizimin, koordinimin dhe kontrollin e veprimtarive kërkimore shkencore dhe ayre akademike të mësimdhënies. Për mbarëvajtjen e programit janë përcaktuar dhe përgjegjësit që ndryshe quhen pedagogët koordinatorë të programeve, veprimtari e të cilëve rregullohet mbi bazën e Rregullores për Udhëheqje/Kujdestari.<br><br>Njësia kryesore dhe bazë organizohet në bazë të marrëveshjes ndërmjet MASR dhe Kolegjit Universitar 'Logos', duke përmbushur detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik konkretisht, njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, lidhur me numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas tre viteve akademike paraqitet si më poshtë:<br><br>
<table>
<tr><th rowspan="2">Tituj/ grada</th><th colspan="2">2019- 2020</th><th colspan="2">2020-2021</th><th colspan="2">2021-2022</th></tr>
<tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr>
<tr><td>Prof.Dr.</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td></tr>
<tr><td>Prof. Asoc.</td><td>1</td><td>3</td><td>-</td><td>2</td><td>-</td><td>3</td></tr>
<tr><td>Dr./PhD.</td><td>2</td><td>4</td><td>3</td><td>5</td><td>3</td><td>4</td></tr>
</table></td></tr>
</table>

<table>
<tr>
<td></td>
<td>
<table>
<tr><td>Msc.</td><td>2</td><td>-</td><td>2</td><td>2</td><td>2</td><td>3</td></tr>
<tr><td>Totali</td><td>5</td><td>8</td><td>5</td><td>10</td><td>5</td><td>11</td></tr>
</table>
<br>
Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.<br>
Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit<br>
Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'<br>
Shtojca 56. Vendimi i Senatit Akademik dhe njoftimi në MARS e riorganizimit të njësive bazë.<br>
Shtojca 58. Marrëveshje MASR, Reduktimi i numrit të personelit akademik.<br>
Shtojca 36. Vendim nr25. i Dekanit FE për përcaktimin e pedagogëve koordinatorë sipas programeve të studimit<br>
Shtojca 36.3. Rregullore Udhëheqje kujdestari për studentët e KU 'Logos'<br>
Shtojca Grup Tabelat 1.1-1.4
</td>
</tr>
<tr>
<td>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</td>
<td>Struktura dhe organizimi i programit të studimit Bsc në Menaxhim Biznesi kërkon angazhimin e personelit për mbikqyrjen e praktikave të studentëve. Njësitë përgjegjëse për programin FE/DM kanë personel të mjaftueshëm që angazhohet për ndjekjen e tyre. Në bazë të marrëveshjes që KU 'Logos' ka me MASR numri i personèlit akademik me kohë të plotë në njësinë bazë është pesë, dhe ky staf mbulon më shumë se 70% të ngarkesës mësumore totale.<br><br>
Në zbatim të akteve rregullatore dhe me qëllim bashkërendimin e veprimtarisë ndërdepartamentale për programet bachelor, FE ka caktuar një koordinator që kujdeset për realizimin e misionit dhe veprimtarinë e gjithanshme të këtyre programeve, sipas përcaktimit të detyrave të tij/saj në rregulloren FE dhe në kontratën e punës individuale.<br><br>
Shtojca 58. Marrëveshje MASR, Reduktimi I numrit të personelit akademik.<br>
Shtojca Grup Tabelat 1.1-1.4<br>
Shtojca Grup Tabelat 4.1-4.4, Grup Tabelat 6 dhe Grup tabelat 12.<br>
Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.<br>
Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit
</td>
</tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | *Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'*<br>*An._1_3_Rregullore e KUQ*<br>*Shtojca 36. Vendim nr25. I Dekanit FE për përcaktimin e pedagogëve koordinatorë sipas programeve të studimit*<br>*Shtojca 36.3. Rregullore Udhëheqje kujdestari për studentët e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. | Departamenti i Menaxhimit, përgjegjës për programin e studimit Bachelor ne Menaxhim Biznesi. Kjo njësi bazë programon, organizon dhe bashkërendon veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore shkencore në disiplinat e ekonomiksit, menaxhimit, marketingut, sipërmarrjes dhe disiplina e lëndë të tjera të ndërlidhura të fushës ekonomike.<br>Njësia kryesore dhe bazë organizohet në bazë të marrëveshjes ndërmjet MASR dhe Kolegjit Universitar 'Logos', duke përmbushur detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. Në bazë të kësaj marrëveshje numri i personeit akademik me kohë të plotë është pesë, nga të cilët dy janë me grada shkencore.<br>*Shtojca 58. Marrëveshje MASR, Reduktimi i numrit të personelit akademik.*<br>*Shtojca Grup Tabelat 1.1-1.4* |
| **Kriteri 4.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. | Njësia kryesore dhe bazë organizohet në bazë të marrëveshjes ndërmjet MASR dhe Kolegjit Universitar 'Logos', duke përmbushur detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. Në bazë të kësaj marrëveshje numri i personeit akademik me kohë të plotë është pesë, nga të cilët dy janë me grada shkencore. KU 'Logos' ka gjithashtu të përshirë në këtë program studimi dhe staf me kohë të pjesshme të cilët janë përzgjedhur në bazë të fushave të tyre të ekspertizës<br>*Shtojca 58. Marrëveshje MASR, Reduktimi I numrit të personelit akademik.*<br>*Shtojca Grup Tabelat 1.1-1.4* |
| **Kriteri 5.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. | E gjithë veprimataria e fakultetit dhe njësive bazë të tij mbështetet në rregulloret e vendosura nga KU 'Logos' dhe në rregulloret e njësive përkatëse, në të cilat pasqyrohen misioni dhe objektivat e secilës prej tyre.<br>Departamenti i Menaxhimit, eshte përgjegjës për programin e studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi. Njësia bazë është përgjegjëse për planifikimin, organizimin, koordinimin dhe kontrollin e veprimtarive |

| | |
|---|---|
| | kërkimore shkencore dhe ayre akademike të mësimdhënies. Për mbarëvajtjen e programit janë përcaktuar dhe përgjegjësit që ndryshe quhen pedagogët koordinatorë të programeve, veprimtari e të cilëve rregullohet mbi bazën e Rregullores për Udhëheqje/Kujdestari.<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'*<br>*An._1_3_Rregullore e KUQ*<br>*Shtojca 36. Vendim nr25. I Dekanit FE për përcaktimin e pedagogëve koordinatorë sipas programeve të studimit*<br>*Shtojca 36.3. Rregullore Udhëheqje kujdestari për studentët e KU 'Logos'* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi II.3**<br><br>**Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuara dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Fakulteti Ekonomik dhe Departamenti i Menaxhimit vënë në dispozicion të gjithë informacionet për programin e studimit organizimin dhe strukturën që programi ka. Të gjithë studentët dhe studentët potencial mund të identifikojnë lehtësisht të gjithë të dhënat e këtij programi. Departamenti i Ekonomisë zhvillon të gjithë aktivitetin në përputhje me legjislacionin në fuqi, në përmbushje të gjithë standardeve të cilësisë për mësimdhënie dhe procesin e kërkimit shkencor.<br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, | Gjatë vizitës në institucion si dhe nga dokumentacioni vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se për programin Baxhelor në |

| | |
|---|---|
| në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. | Menaxhim Biznesi, njësia kryesore dhe ajo bazë disponon të gjithë dokumentacionin lidhur me strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit ku përfshihen, statuti i KU 'Logos', rregullorja e Fakultetit dhe Departamentit, rregullorja e programit mesimor, plani strategjik për zhvillimin e programit, plani mësimor, syllabet lëndore etj.<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra. | Organizimi i programit të studimit gjendet i pasqyruar në planin mësimor, ku përfshihen informacionet për lëndet/modulet, praktikë profesionale, diploma, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian (ECTS). Ato janë të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese përcaktuar nga aktet ligjore në fuqi (aktualisht VKM nr. 41, 24.01.2018). Kategorizimet e lëndëve të këtij programi janë:<br><br>1. A-Lëndë bazë: (33 kredite), 18.3%<br>2. B-Lëndë karakterizuese: (90 kredite), 50%<br>3. C-Lëndë ndërdisiplinore/integruese: (25.5 kredite), 14.2%<br>4. D-Lëndë plotësuese: (25.5 kredite), 14.2%<br>5. E-Detyrime përmbyllese: (6 kredite), 3.3%<br><br>Secili vit mësimor është i organizuar në 60 kredite dhe programi ka 180 ETCS.<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e | Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj. Ndarja e orëve dhe ngarkesës mësimore në auditor dhe jashtë tij bëhet në përputhje me kreditet, ku cdo kredit i korispondon 25 orë mësimore pune të studentit. Studetët informohen në fillim të cdo viti për programin, përmbajtjen e tij, |

| | |
|---|---|
| vlerësimit të dijeve etj. | pedagogët, orarin mësimor, detyrimet e frekuentimit etj.<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'*<br><br>*Shtojca Tabela nr.10.*<br><br>*Shtojca 14. Plani mësimor i programit të studimit Bsc në Menaxhim Biznesi* |
| **Kriteri 5.** Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Programi i studimit ka rregulloren e vet ku përfshihet i gjithë informacioni i nevojshëm për studentët në lidhje me pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve. Procesi i pranimit të studentëve bazojet në nenin 74 të ligjit Nr.1 80/2015 'Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë'.<br><br>Procedurat e pranimit përcaktohen në aktet rregullatore te institucionit, përfshirë rregulloren e programit të studimit dhe shpallen në të gjitha mjetet e informimit të institucionit. Procedurat e pranimit të studentëve të rinj realizohen nga një komision i veçantë pedagogësh duke marrë parasysh vit pas viti kriteret bazë të vendosura nga Ministria përgjegjesë për arsimin dhe kritere të veçanta që vendos vetë institucioni.<br><br>Programi është i organizuar në mënyrë që të lejojë transferim të studimeve nga/në programe të tjera, duke bërë ekuivalentimin e njohurive të shprehura në ECTS. Procedura e transferimeve përcaktohet në aktet rregullatore të KU 'Logos' dhe shprehet e përmbledhur në një udhëzues të posacëm.<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'*<br><br>*Shtojca Tabela nr.10.*<br><br>*Shtojca 14. Plani mësimor i programit të studimit Bsc në Menaxhim Biznesi*<br><br>*Shtojca 80 Vendim Senati për Miratimin e KRitereve të pranimit të studentëve për programet e studimit që Kolegji Universitar Logos ofron për vitit akademik*<br><br>*Shtojca 85. Vendim Dekanati FE 'Rregullore e transferimeve* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 6.** Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | Nga shqyrtimi i dokumentacionit, përkatësisht syllabuset e lëndëve, GVJ konstatoi se në përgjithësi në syllabusin e cdo lënde paraqitet informacion i detajuar. Formati i syllabusit është i përcaktuar sipas një formati të gjithëpranuar. GVJ konstaton se syllabuset e lëndëve janë organizuar duke pasur në përmbajtje, objektivat, temat, literaturën bazë dhe ndihmëse, emrin e titullarit, numrin e krediteve si dhe ngarkesën leksion seminar.<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë. | Nga intervistat gjatë takimeve, GVJ konstatoi se programi lëndor (syllabet) diskutohen në fillim të cdo viti akademik dhe dokumentacioni firmoset nga titullari i lëndës dhe përgjegjësi i departamentit. Në rast përmirësimesh dhe ndryshimesh të syllabuseve duhet të bazohen në rregullore. Sipas kësaj rregulloreje ndryshimet propozohen nga Departamenti, por edhe nga anëtarë të personelit akademik, në konsultim me ekspertë të fushës, si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme. Ai shqyrtohet në Departament dhe dërgohet për miratim në mbledhjen e Dekanatit.<br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi II.4**<br><br>**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet | Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi në KU 'Logos' respekton përcaktimet e akteve ligjore e nënligjore (aktualisht VKM 41/ 2018). Plani mësimor përfshin orë |

| | |
|---|---|
| ligjore e nënligjore në fuqi. | në auditor për leksione, seminare, praktikë etj dhe orë pune të pavarur që janë orë jashtë auditorit.Kurrikula është e shpërndarë në tre vite akademike ku secili vit ka 60 ETCS dhe jo më pak se 1500 orë totale. Programi është në përputhje me ligjet ne fuqi.<br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'*<br>*Shtojca Tabela nr 10.*<br>*Shtojca nr 14.3 Plani mësimor i programit të studimit Bsc në Menaxhim Biznesi* |
| **Kriteri 2.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | Emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive kryesisht mundësojnë thellimin e njohurive të fushës se menaxhimit dhe administrimit. Në këtë program ka një kombinim dhe ndërthurje të lëndëve që zhvillen në të gjashtë semestrat, për të siguruar një përshtatje me njohuritë që studentët duhet të marrin dhe me kërkesat dhe nevojt e tregut. Njohuritë e marra përgjatë këtij cikli studimi i mundësojnë studentëve profilizimin dhe thellimin e mëtejshëm të njohurive në cikle të tjera studimesh. Praktika profesionale dhe përgatitja e tezës së diplomës, me të cilën përmbyllen studimet, luajnë rol thelbësor në këtë drejtim. Kjo evidentohet në planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve të programit.<br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'*<br>*Shtojca 19. Syllabuset e lëndëve të programit Bsc në Menaxhim Biznesi.* |
| **Kriteri 3.** Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. | Në harmoni me ligjet dhe VKM në fuqi plani mësimor i programit të studimit Bsc në Menaxhim Biznesi siguron një shpërndarje të tillë të lëndëve mësimore:<br>1. A-Lëndë bazë: (33 kredite), 18.3%<br>2. B-Lëndë karakterizuese: (90 kredite), 50%<br>3. C-Lëndë ndërdisiplinore/integruese: (25.5 kredite), 14.2%<br>4. D-Lëndë plotësuese: (25.5 kredite), 14.2% |
| | 5. E-Detyrime përmbyllese: (6 kredite), 3.3%<br>Sipas planit mësimor shpërndarja e lëndëve në semestra mundëson dhe ndjek parimin e marrjes së njohurive në mënyrë |

| | |
|---|---|
| | graduale, nga konceptet themelore tek ato të avancuara dhe të aplikueshme. Ky shkallëzim mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.<br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'*<br>*Shtojca nr 14.3 Plani mësimor i programit të studimit Bsc në Menaxhim Biznesi* |
| **Kriteri 4.** Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. | Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me bazën ligjore në fuqi si dhe me profilin e programit. KU 'Logos' ka bërë ndryshimet e rekomanduara më parë në lidhje me planin mësimore duke përafruar në këtë mënyrë programin me programe të ngjashme ndërkombëtare.<br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'*<br>*Shtojca nr 14.3 Plani mësimor i programit të studimit Bsc në Menaxhim Biznesi* |
| **Kriteri 5.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | Veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program studimi grupohen në 5 kategori, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. KU 'Logos' synon që zhvillimi i kurrikulave të programit t'i referohet praktikave më të suksesshme, me qëllim rritjen e përputhshmërisë së tyre me kurrikulat në universitetet e tjera brenda dhe jashtë vendit, për të lehtësuar transferimin e studimeve dhe njohjen e krediteve, dhe për të rritur mundësitë e bashkëpunimit me universitetet e tjera. Bazuar tek sistemi i njohurive që ofrohet nga ky program dhe kompetencat që përftojnë studentët nëpërmjet tij, u mundësojnë atyre edhe vazhdimine studimeve të ciklit të dytë, duke rritur kështu mundësinë e karrierës së tyre profesionale.<br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'*<br>*Shtojca nr 14.3 Plani mësimor i programit të studimit Bsc në* |

| | |
|---|---|
| | *Menaxhim Biznesi* |
| **Kriteri 6.** Programet e lëndëve/ moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. | Syllabet e lëndëve ndjekin procesin e përditësimit cdo vit akademik, fakt i konfirmuar dhe gjatë vizitës në institucion nga stafi i Departamentit dhe nga përgjegjesi i saj. GVJ në rishikim të dokumentacionit vëren se syllabet e lëndëve janë përditësuar sipas kërkesave ligjore dhe fushatës 'Një libër më shumë për bibliotekën e Logosit'.<br><br>*Shtojca 19. Syllabuset e lëndëve të programit Bsc në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'*<br><br>*Shtojca nr 14.3 Plani mësimor i programit të studimit Bsc në Menaxhim Biznesi*<br><br>*Shtojca 45.4. Fushata një libër më shumë për bibliotekën e LOGOSIT* |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të parë. | Programi i studimit Bsc në Menaxhim Biznesi garanton përfitimin e dijeve, aftësiv dhe kompetencave të synuara në lidhje me fushën e menaxhimit. Ky program ofron thellimin gradual në dijet e ofruara duke mundësuar përfitimin e synuar në ciklin e parë të studimit.<br><br>*Shtojca 19. Syllabuset e lëndëve të programit Bsc në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'*<br><br>*Shtojca nr 14.3 Plani mësimor i programit të studimit Bsc në Menaxhim Biznesi* |
| **Kriteri 8.** Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | GVJ kostaton në bazë të dokumentave se sistemi i njohurive që ofrohet nga ky program dhe kompetencat që përftojnë studentët nëpërmjet tij, u mundësojnë atyre vazhdiminë studimeve të ciklit të dytë, duke rritur kështu mundësinë e karrierës së tyre profesionale, por edhe punësimin e tyre direkt në përputhje me kërkesat e tregut.<br><br>*Shtojca 19. Syllabuset e lëndëve të programit Bsc në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *Biznesi.*<br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'*<br>*Shtojca nr 14.3 Plani mësimor i programit të studimit Bsc në Menaxhim Biznesi* | | | |
| **Kriteri 9.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. | Bazuar në vizitën e bërë në institucion dhe komunikimin me instancat drejtuese, për përmirësimin e programit të studimit departamenti si njësi bazë drejtuese zhvillon takime me institucionet që ka bashkëpunim, intervista dhe survejime me studentë e staf akademik. E gjithë kjo përkthehet në mundësi dhe oportunitet për përmirësim bazuar në kërkesat e tregut dhe të gjithë stakeholdersat e përfshirë në proces.<br>*Shtojca 17. Të dhëna për punësimin e studentëve*<br>*Shtojca 57. Vlerësim punëdhënësi për ALUMNI*<br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi II.5**<br><br>**Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi. | Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit Bsc në Menaxhim Biznesi, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi. Ky program studimi ka të angazhuar pesë staf akademik me kohë të plotë ku tre prej tyre janë me titullin doktor dhe dy prej tyre janë asistent lector me titull Msc. Gjithashtu ky program ka të angazhuar 11 staf akademik me kohë të pjesshme ( 1 staf me titullin Profesor Doktor, tre me titullin Profesor të Asociuar, katër me titullin Doktor dhe tre me titull Msc.)<br>Nga të dhënat, GVJ evidenton që stafi akademik PAE përgjegjës |

| | |
|---|---|
| | për këtë program studimi, është më i vogël se stafi akademik PAK i angazhuar në këtë departament (5 PAE / 11 PAK).<br><br>*Shtojca Tabela 1.4*<br><br>*Shtojca Tabela 12* |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit. | GVJ konstaton se programi mbulohet me staf akademk efektiv dhe staf akademik me kontratë. Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me disa kontrata pune të pedagogëve efektivë dhe me kontratë. Në pjesën më të madhë të tij personeli akademik efektiv dhe me kontratë ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik që kërkon ligji si në drejtimin e programit të studimit edhe në zhvillimin e lëndëve përkatëse.<br><br>*Shtojca nr20. CV e stafit akademik të programit të studimit*<br><br>*Shtojca grup Tabelat 12* |
| **Kriteri 3.** Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij. | GVJ bazuar në dosjet dhe Cv e stafit akademik sikurse dhe në vizitën në institucion, konstatoi përputhshmëri të fushës akademike-kërkimore të personalit akademik me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.<br><br>*Shtojca nr20. CV e stafit akademik të programit të studimit*<br><br>*Shtojca nr 43. Të dhënat për kualifikime kërkim shkencor për pesë vitet e fundit*<br><br>*Shtojca Tabelat 19 dhe 20* |
| **Kriteri 4.** Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | Kolegji universitar 'Logos' vë në dispozicion personelin e brendshëm për instruktim, udhëheqje dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale. Raporit pedagog student për këtë program studimi është i favorshëm. Praktikat profesionale në bazë të dokumentacionit në dispozicion zhvillohen pranë kompanive që KU 'Logos' ka marrëveshje bashkëpunimi.<br><br>Në dokumentacionin e paraqitur nga insticioni përshkruhen me hollësi procedurat e zhvillimit të praktikës si dhe udhëzimet për punimin e diplomës.<br><br>*Shtojca nr 68. Ndjekja e studnetëve për diplomim*<br><br>*Shtojca nr 78. Dosje e plotë e praktikës profesionale programi i studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi* |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e | Referuar RVB si dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se KU 'Logos' garanaton dhe siguron infrastrukturë laboratorike dhe |

| | |
|---|---|
| personelit ndihmësmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit | profesionale. Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor e specialistë të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe praktikave profesionale edhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit që ofrohet.<br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'*<br>*Shtojca nr 14.3 Plani mësimor i programit të studimit Bsc në Menaxhim Biznesi* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| **Standardi III.1**<br>**Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve. | Në programin e studimit Msc në Menaxhim Biznesi përdoren format e mësimëdhënies dhe transferimit të dijeve si: leksione, seminare, detyra kursi, ushtrime/laborator, praktikë dhe diplomë. KU 'Logos'bazohet në metodat e reja të mësimëdhënies hibride ose online, dhe në këtë program janë përdorur disa platforma të mësimëdhënies online si Google Classroom, Google Meet, Zoom dhe Teams. Për përdorimin e platformave janë krijuar dhe dokumentuar udhëzues, të cilat gjënden në gjuhën shqipe dhe angleze në faqen e internetit të institucionit. Në këtë program studimi për të përmbushur nevojën e metodave të ndryshme dhe inovatore të mësimëdhënies zhvillohen leksione të hapura dhe orë mësimore interaktive të drejtuara jo vetëm nga teoria, por dhe nga aplikueshmëria praktike e tyre.<br>*Shtojca nr 14.3 Plani mësimor i programit të studimit Bsc në Menaxhim Biznesi*<br>*Shtojca nr 66.1* |

| | |
|---|---|
| | *Shtojca nr 39.1-39.8* |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. | GVJ bazuar në RVB dhe në vizitën dhe takimet e zhvilluara në institucion identifikoi që vlerësimi dhe monitorimi i cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies bazohen në statutin dhe rregulloret e institucionit. Departamenti ndjek rregullisht ecurinë e procesit mësimor dhe monitoron rregullisht aftësitë mësimdhënese të personelit akademik dhe pedagogjik.Vlerësimi i stafit akademik për mësimdhënien synojnë të stimulojne dhe inkurajojnë pedagogët që aplikojnë metoda të reja mësimdhënie, dhe ky vlerëim nuk është i diferencuar.<br><br>Monitorimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të stafit akademik kryhet në mënyrë periodike nga departamenti dhe fakulteti përkatës në bashkërendim me NJSBC nëpërmjet vlerësimit të performancës së tyre dhe nëpërmjet rezultateve të pyetësoreve të plotësuara nga studentët. Vlerësimi i stafit akademik gjithashtu bëhet për cdo akademik nga përgjegjësi i departamentit.<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'*<br><br>*Shtojca 2. Statuti i KU 'Logos'*<br><br>*Shtojca 13. Politika për Sigurimin e Cilësisë*<br><br>*Shtojca 8. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë* |
| **Kriteri 3.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. | Departamenti dhe fakulteti organizojnë rregullisht metoda të përfshirjes së studentëve në vlerësimin e formave, metodave dhe nivelit të mësimdhënies. Institucioni nëpërmjet Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë kryen pyetsorë për studentët. Pyetsorët plotësohen online dhe rezultatet e tyre kalohen pedagogëve dhe përgjegjësit të departamentit. GVJ konstaton se studentët përfshihen në vlerësimin e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve nëpërmjet dhe pyetësorëve, si edhe paraqitjes së ankesave kundrejt pakëkanqësive të tyre lidhur me format e vlerësimit.<br><br>*Shtojca 8. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë*<br><br>*Shtojca 37 Dosja e NJSBC.* |
| **Kriteri 4.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | NJSBC-ja, si njësia përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në institucion, pasi realizon sondazhet e studentëve, rezultatet e përpunara i dërgohen përgjegjësit të departamentit, dekanit, u bëhen publike pedagogëve dhe pasi diskutohen në Rektorat, studentëve ju komunikohen problemet e evidentuara dhe |

| | |
|---|---|
| | masat që do të marrë Rektorati dhe dekanati në të ardhmen. Ky raport bëhet pjesë e raportit institucional dhe miratohet në Rektorat, Senat Akademik dhe Bord t Administrimit dhe paraqitet dhe në Ministrinë e arsimit<br>*Shtojca ne 89. Fakulteti Ekoomik-Raport Vjetor 2021*<br>*Shtojca 65.2 Raporti institucional 2020-2021* |
| **Kriteri 5.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, evidentohet se Fakulteti dhe Departamenti përgjegjës për këtë program studimi përdorin mënyra për vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Një nga mënyrat e përdorura është promovimi i shëmbujve dhe praktikave të mira për nxitje dhe inkurajim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Pyetësori i studentëve përdoret si mjeti që përdoret për të evidentuar dhe vlerësuar shembuj të mirë dhe efikas në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.<br>Por, në analizat vjetore të programit apo të procesit të mësimdhënies së Departamentit të Menaxhimit që mbulon këtë program, nuk ka të dokumentuar raste të diferencuara, shembuj të praktikave të mira apo emra pedagogësh apo lëndësh që duhen promovuar dhe inkurajuar, që janë të mirëvlerësuar dhe që janë për këtë shkak të diferencuar nga pjesa tjetër e stafit.<br>*Shtojca ne 89. Fakulteti Ekoomik-Raport Vjetor 2021* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

**Standardi III.2**

**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**

| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Në programin mësimor Bsc në Menaxhim Biznesi format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyra kursi, praktikat profesionale dhe detyrimet përmbyllëse. Këto forma janë në përputhje të plotë me ligjet dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Në procesin mësimor janë aplikuar edhe ftesa për personal akademik të jashtëm apo për personalitete të fushës të cilët kanë ofruar leksione të hapura dhe kanë sjellë në auditor eksperiencat e tyre apo të institucionave që kanë drejtuar.<br>*Shtojca nr 14.3 Plani mësimor i programit të studimit Bsc në* |

| | |
|---|---|
| | *Menaxhim Biznesi*<br>*Shtojcat 59.1-59.4 -Ëebinar, Ëorkshop, Tryeza të Rrumbullakta, Leksione të hapura, Konferenca Studentore.* |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti. | Bazuar nga informacionet e grumbulluara në takimet me studentët dhe stafin akademik dhe në RVB, rezulton se stafi akademik i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke përshtatur dhe ofruar mundësi dhe forma alternative të mësimdhënies, mësimnxënies dhe të kontrollit të dijes. Nga bashkëbisedimi me studentët u konstatua se përveç leksioneve, gjatë seminareve krahas kontrollit të njohurive nëpërmjet pyetjeve/përgjigjeve dhe diskutimeve, aplikohen edhe raste studimore e detyrat individuale me studentët. Natyra specifike e këtij program studimi kërkon përdorimin dhe aplikimin e metodave të larmishme të mësimdhënies nëpërmjet kompjuterave dhe sistemit të rrjeteve të internetit. Nevojat e studnetëve fokusohen në preferencën për përzgjedhjen e nënfushave të studimit dhe temave të diplomës.<br>*Shtojca 67.1 Format për realizimin e detyrave të kursit*<br>*Shtojca nr 14.3 Plani mësimor i programit të studimit Bsc në Menaxhim Biznesi* |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. | KU 'Logos' mundëson përdorimin e metodave fleksibël pedagogjike për të arritur rezultatet e pritshme të mësimdhënies dhe mësincënies. Stafi pedagogjik për arritjen e kësaj pritshmërie është pjesë e trajnimeve në kuadër të programit Erasmus.<br>Grupi vlerësues sugjeron shtimin e këtyre trajnimeve në kuadër të programit Erasmus por dhe të programeve të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.<br>*Shtojca nr79. Trajnime nga Institucioni për mësimdhënien*<br>*Shtojca nr 63.3. Staff Mobility.* |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit. | Nga informacioni i siguruar nga studentët, gjatë vizitës në institucion si dhe referuar CV-ve, fushave të ekspertizës dhe eksperiencës së stafit, rezulton se stafi akademik është kompetent në shpjegimin e koncepteve dhe transmetimin e njohurive, nëpërmjet përdorimit të metodave të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit përkatës. Në kontrollin rastësor që GVJ kreu për dosjet e personelit u vërejt përputhje e profilit të lëndës me specialitetin e pedagogut. Personeli akademik është kompetent në shpjegimin e njohurive<br>*Shtojca nr 20. CV e stafit akademik të programit të studimit* |
| **Kriteri 5.** Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e | Institucioni i jep rëndësi zhvillimit me korrektësi të procesit mësimor nga ana e pedagogëve. Institucioni periodikisht vlerëson |

| | |
|---|---|
| metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | format dhe metodat e mësimdhënies, me qëllim përmirësimin e këtyre metodave në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, duke përfshirë edhe studentët. Studentet i shprehin shqetësimet dhe sugjerimet e tyre nëpërmjet pyetsorëve semestralë të cilat administrohen dhe analizohen nga departamenti dhe NJSBC. Këto rezultate të vlerësuara shërbejnë si pikënisje për vitin e ardhshëm akademik, për përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe përfshirjes së studentëve në process.<br>*Shtojca ni 38.1 Raporti vjetor i Departamentit të Menaxhimit 2020-2021*<br>*Shtojca nr40. Pyetësori i studentëve*<br>*Shtojca 41 Pyetësori i stafit akademik dhe ndihmësakademik* |
| **Kriteri 6.** Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit. | Personeli akademik përdor përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i përfshirë studentët në diskutime, analiza apo zgjidhje rastesh studimore etj. Nga vizita ne institucion mësuam se personeli akademik përpiqet që të angazhojë studentët me diskutime brenda fushës së lëndës apo realizojnë konkurse dhe vizita studimore, për ta bërë më tërheqëse orën e mësimit, të përdorë case study, apo të përfshijë raste nga tregu lokal.<br>*Shtojca nr 14.3 Plani mësimor i programit të studimit Bsc në Menaxhim Biznesi*<br>*Shtojcat 59.1-59.4 -Ëebinar, Ëorkshop, Tryeza të Rrumbullakta, Leksione të hapura, Konferenca Studentore.* |
| **Kriteri 7.** Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre | Programi i studimit Bsc në Menaxhim Biznesi nëpërmjet metodave interaktive të mësimdhënies dhe mësimnxënies mundëson dhe inkurajon sensin e autonomisë së studentit. Duke pasur si synim studentin në qendër, përdorimi i formave të reja të mësimdhënies inkurajon të menduarin e pavarur dhe kritik nga ana e studentëve si dhe i bën ata më të hapur dhe të aftë të artikulojnë lirisht opinionet e tyre.<br>*Shtojca nr 14.3 Plani mësimor i programit të studimit Bsc në Menaxhim Biznesi*<br>*Shtojca 67.3- Detyra kursi mbi bazë grupi në lëndën MEnaxhim Projekti* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.3**<br><br>**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht. | Nga vizita në institucon GVJ evidentoi se mjediset ku zhvillohet veprimtaria e mësimdhënies e mësimnxënies përmbush të gjitha standartet ligjore për hapësirat e mjaftueshme dhe cilësore. Të gjitha ambjentet ku zhvillohen seminaret dhe leksionet janë të përshtatshme për numrin e studentëve që ka ky program mësimor. GVJ konstatoi që ambjentet janë të paisura me sisteme ngohjeje dhe ftohjeje, janë të ndricuara në mënyrë optimale dhe mirëmbahen rregullisht. Sipas RVB në Fakultetin Ekonomik sipërfaqja për cdo sutedent është 24 $m^2$, duke përmbushur në këtë mënyrë normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme, referuar VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 sipas të cilit kërkohen 2.5 $m^2$ / student.<br><br>*Shtojca nr 42. Dokumentacioni në lidhje me infrastrukturën e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 2.** Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor. | Përgjatë vizitës në institucion GVJ konstratoi që ambjentet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit. Ambjentet ishin të paisura me kompjutera dhe projector. Gjithashtu këto ambjente kishin në mënyrë të pandërprerë internet, i cili garanton realizimin e procesit cilësor mësimor.<br><br>*Shtojca nr 42. Dokumentacioni në lidhje me infrastrukturën e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 3.** Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor. | KU 'Logos' ka pajisur zyrat e personelit akademik të cilat ofrojnë kushtet e nevojshme nga pikëpamja infrastrukturore për të realizuar punën e tyre akademike, dhe procesin mësimor, kjo e paraqitur në RVB në nivele të larta integrimi të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit edhe nëpër auditore.<br><br>*Shtojca nr 42. Dokumentacioni në lidhje me infrastrukturën e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 4.** Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e | KU 'Logos' ka vënë në dispozicion për studentët e të gjitha cikleve të studimit, përfshirë dhe këtë program studimi, sikurse dhe për stafin akademik, bibliotekën 'Logos'. Kjo bibliotekë është në kampusin kryesor dhe ka një strategji të vecantë për zhvillimin dhe pasurimin e saj. Literatura në bibliotekë mund të shfrytëzohet në formë fizike dhe elektronike. Studentët dhe stafi akademik kanë të drejtë të huazojnë librat fizik për ti përdorur ato edhe jashtë |

| | |
|---|---|
| studimit. | bibliotekës.<br><br>*Shtojca nr 42. Dokumentacioni në lidhje me infrastrukturën e KU 'Logos'*<br><br>*Shtojca nr 45.2 Strategjia e bibliotekës 2019-2023* |
| **Kriteri 5.** Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor. | Bilioteke e KU 'Logos' vë në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik literaturë në gjuhën shqipe dhe të huaj sipas kërkesave të departamentëve përkatëse, të cilat lidhen me programet mësimore. Sipas RVB gjatë tre viteve të fundit biblioteka është paisur me 95 tituj tëri në gjuhn shqipe, anglisht dhe në gjuhën greke. GVJ evidentoi që fondi i bibliotekës, në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, pasurohet në mënyrë të vazhdueshme, duke synuar reflektimin e ndryshimeve cilësore të programit të studimit si edhe azhornimin me zhvillimet më të fundit të literaturës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Ky pasurim ka ardhur edhe si rezultat i fushatës që institucioni ka bërë, fushata 'Një libër më shumë për bibliotekën e Logosit'.<br><br>*Shtojca nr 42. Dokumentacioni në lidhje me infrastrukturën e KU 'Logos'*<br><br>*Shtojca nr 45.2 Strategjia e bibliotekës 2019-2023*<br><br>*Shtojca 45.1 Lista e titujve në bibliotekë për Departamentin e Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 45.4 Fushata-Një libër më shumë për bibliotekën e Logosit.* |
| **Kriteri 6.** Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit. | Në institucion ofrohej akses falas dhe i barabartë në Katalogun elekronik të bibliotekës Logos -ëëë.orthodoxalbania.org.<br><br>Bibliotekat online të cilat mud të aksesohen nga studentët dhe stafi akademik janë JSTORE dhe EBSCO. Gjithashtu institucioni ofron aksesin dhe në revistën MONITOR. Bazuar në RVB por dhe në takimet në institucion për aksesin më të lehtë të bibliotekës janë zhvilluar trajnime nga përgjegjësja e bibliotekës.<br><br>*Shtojca 45.6 Llogaria në Bibliotekën Online*<br><br>*Shtojca 45.5 Trajnime për bibliotekën* |
| **Kriteri 7.** Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët. | KU 'Logos' ka salla konferencash dhe ambjente studimi në bibliotekë të cilat janë në funksion të studentëve për realizimin e detyrave të kursit, diplomave apo edhe prezantimin e tyre. Nga informacioni i siguruar nga vizita në institucion si dhe nga RVB-ja, studentët e programit Bsc në Menaxhim Biznesi si dhe stafi akademik, kanë mundësinë që të aksesojnë dokumentacionin elektronik, të doënlodojnë leksionet etj. Institucioni disponon |

| | |
|---|---|
| | infrastrukturën e nevojshme për realizimin e objektivave mësimore<br><br>*Shtojca 45.6 Llogaria në Bibliotekën Online*<br><br>*Shtojca 45.5 Trajnime për bibliotekën*<br><br>*Shtojca nr 42. Dokumentacioni në lidhje me infrastrukturën e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 8.** Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre. | Komunikimi i brendshëm mes stafit akademik dhe studentëve, bëhet nëpërmjet platformës Microsoft Office 365 dhe EduPage. Për përdorimin e këtyre platformave janë krijuar dhe shpërndarë manualet e përdorimit. Mirëfunksionimi i sistemeve dhe ndihma teknike jepet nga IT. Platformat janë në përdorim nga stafi akademik dhe studentët edhe në kushtet e zhvillimit të mësimit me prani fizike<br><br>*Shtojca 71..2 Përdorimi i MS Teams*<br><br>*Shtojca nr 42. Dokumentacioni në lidhje me infrastrukturën e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 9.** Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar. | Studentët dhe pedagogët përdorin sistemin elektronik Microsoft Office 365 që është i disponueshëm për të gjithë strukturat. Ky sistem përdoret për të shkëmbyer informacionin midis pedagogëve dhe studentëve dhe strukturave të tjera të universitetit. Gjithashtu studentët dhe pedagogët janë të pajisur me një adresë postare nga institucioni (emër.mbiemër@kulogos.edu.al për pedagogët dhe emër.mbiemër@s.kulogos.edu.al për studentët) e cila mundëson komunikimin e shpejtë dhe efektiv pedagog-student dhe anasjelltas.<br><br>*Shtojca 71..2 Përdorimi i MS Teams*<br><br>*Shtojca nr 42. Dokumentacioni në lidhje me infrastrukturën e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 10.** Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre | Në KU 'Logos' personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave. Studentët janë ata që shprehin interesin e tyre në lidhje me pedagogun udhëheqës dhe temës apo fushës së tyre të interest. Departamenti shqyrton të gjitha kërkesat specifike të studentëve, duke i harmonizuar ato me kushtet aktuale. Tezat e diplomës dhe pedagogët që do të udhëheqin punimin e tyre, përcaktohen nga departamenti. Refereuar RVB, studentët zgjedhin temën e diplomës dhe pedagogun udhëheqës një muaj nga fillimi i vitit akademik.<br><br>*Shtojca 5 Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të MEnaxhimit*<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit* |

| | *Shtojca 68. Ndjekje e studentëve për diplomim* | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi III.4**<br><br>**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. | Për monitorimin, garantimin dhe përmirësimin e cilësisë, institucioni ka në përbërje të tij tre komisione krysore. Komisioni I Përhershëm i Garantimi të Cilësisë, Komisioni i Përhershëm për marrëdhëniet me Studentët, Këshilli i Etikës si dhe Njësia e Sigurimi të Brendshëm të cilësisë, ndjekin dhe vlerësojnë punën me njësinë bazë dhe atë kryesore për monitorim të procesit të mësimdhënies.<br><br>*Shtojca 66.7 dhe 66.8 Komisionet*<br><br>*Shtojca nr 37. Aktiviteti i NJSBC*<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'*<br><br>*Shtojca 2. Statuti i KU 'Logos'*<br><br>*Shtojca 13. Politika për Sigurimin e Cilësisë*<br><br>*Shtojca 8. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë* |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron. | GVJ nga kontaktet e realizuara gjatë visitës në institucion dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatoi se njësia kryesore dhe ajo bazë nxit dhe mbështet proceset, të cilat synojnë rritjen e vetëdijes për rëndësinë e cilësisë së programit të studimit. Fakulteti Ekonomik dhe Departamenti i Menaxhimit janë strukturat përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë dhe rritjen e vetëdijes të stafit akademik dhe studentëve.<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'*<br><br>*Shtojca 2. Statuti i KU 'Logos'* |
| **Kriteri 3.** Strukturat dhe njësitë | Strukturat dhe njësitë përgjegjëse jo vetëm mbështesin por dhe |

| | |
|---|---|
| përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. | inkurajojnë zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. Stadi akademik në mënyrë që të rrisë mundësitë e zhvillimit të aftësive për mësimdhënie innovative kryen trajnime në rang institucional dhe Erasmus, bazuar në marrëveshjet që institucioni ka.<br>*Shtojca nr 34.1 Marrëveshje bashkëpunimi KU Logos me IAL brenda dhe jashtë vendit*<br>*Shtojca nr 63.3 Staff Mobility*<br>*Shtojca nr79. Trajnime nga Institucioni për mësimdhënien* |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | Gjatë vizitës në intitucion GVJ konstatoi se trajnimi dhe zhvillimi i stafit akademik ishte një pjesë e rëndësishmë e aktiviteteve të KU 'Logos'. Kualifikimet e stafit për mësimdhënie lidhen me trajnimet e tyre në bashkëpunim me IAL të tjera brenda dhe jashtë vendit. Ky kualifikim i personelit akademik të Fakultetit dhe Departamentit ka ndihmuar dukshëm në përmirësimin e mëtejshëm të procesit të mësimdhënies.<br>*Shtojca nr79. Trajnime nga Institucioni për mësimdhënien* |
| **Kriteri 5.** Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja. | Në vazhdimësi personeli akademik i Fakultetit dhe Departamentit të Menaxhimit, kualifikohet brenda institucionit, në zbatim të udhëzuesit të stafit akademik si dhe në kuadër të marrëveshjeve me institucione të tjera homologe përmes trajnimeve, diskutimeve, leksioneve të hapura i kanë shërbyer trjanimit të stafit akademik për përmirësimin e aftësime të mësimdhenies dhe të metodave të reja në mësimdhënie.<br>*Shtojca nr79. Trajnime nga Institucioni për mësimdhënien* |
| **Kriteri 6.** Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. | Stafi akademik përpara fillimit të vitit akademik paraqet kërkesat e përmirësimit të syllabuseve mbështetur në rezultatet e NJSBC. Gjithashtu këto ndryshime vijnë dhe si pasojë e trajnimeve apo përvojave të viteve paraardhëse të stafit akademik, për të përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme mësimdhënien në institucion.<br>*Shtojca nr 64. Procesverbal i Departamentit të Menaximit, miratimi i syllabuseve 2021-2022*<br>*Shtojca nr79. Trajnime nga Institucioni për mësimdhënien* |
| **Kriteri 7.** Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet | Të gjitha ndryshimet që aplikohen në një vit akademik, analizohen dhe raportohen në Departamentin përgjegjës për programin e studimit. Performanca e personelit akademik si dhe rezutlatet e punës së tyre analizohen në mbledhjet periodike të departamentit si dhe në raportin periodik të NJSBC. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| në strukturat dhe njësitë përgjegjëse. | *Shtojca nr 64. Procesverbal i Departamentit të Menaximit, miratimi i syllabuseve 2021-2022*<br><br>*Shtojca nr79. Trajnime nga Institucioni për mësimdhënien* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi III.5**<br><br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në bazë të zbatimit të VKM-ve në fuqi dhe në respektim të rregullores së programit. Konkretisht, në përputhje me parashikimet në syllabuse, metodat e vlerësimit përfshijnë testimet, detyra kursi, si dhe provime përfundimtare. Format e kriteret e vlerësimit të dijeve për studentët janë të përcaktura në Rregulloren e Fakultetit dhe në Rregulloren e programit të studimit.<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Bazuar në RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ evidentoi se në javën e parë të cdo semestri gjatë prezantimit të programit bëhet dhe prezantimi i metodologjisë së vlerësimit të njohurive duke e arsyetuar dhe shpjeguar dhe këtë metodologji.<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra | Referuar rregullores së programit, syllabuseve dhe informacionit të siguruar nga stafi akademik dhe studentët, rezulton se në syllabus janë parashikuar format e vlerësimit dhe masa e vlerësimit të çdo komponenti. Këto forma janë alternative dhe të ndryshme duke iu dhënë mundësi studentëve, të demonstrojnë |

| | |
|---|---|
| të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara | njohuritë e përfituara.Grafikët e provimeve shpallen para fillimit të sezonit. Në formën e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, kthehet në notë. Tezat e provimit hartohen nga pedagogu i lëndës dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit.<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.6**<br><br>**Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik. | Nga verifikimet u konstatua që testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar. Ky testim dhe vlerësim është i bazuar në Rregulloren e Përgjithshme dhe atë të programit të studimit. Ky vlerësim ndahet në dy pjesë:<br>1. Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e modulit të tilla si: pjeëmarrje dhe aktivizim, testim i ndërmjetëm dhe detyra kursi;<br>2. Vlerësimi përfundimtar i cili bazohet në provimin përfundimtar;<br><br>Studentët njoftohen për vlerësimin për secilën nga rubrikat sapo ato plotësohen dhe janë në dijeni të pikëve të marra nga vlerësimi i vazhdueshëm përpara se të xhvillojnë testin përfundimtar.<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme | Bazuar në dokumentacion, institucioni ka zbatuar përdorimin e sistemeve elektronike të testimit dhe vlerësimit përgjatë kushteve të zhvillimit të mësimit online. Për mësimdhënien në prani fizike korrektesa dhe transparenca sigurohet nëpërmjet procesit të |

| | |
|---|---|
| abuzimi dhe rrisin transparencën. | sekretimit, dhënies së notave në mënyrë individuale për cdo student duke eleminur në këtë mënyrë mundësitë e abuzimit. Ky proces zhvillohet jo vetëm në mënyrë fizike por dhe nëpërmjet përdorimit të platformës Microsoft Office 365.<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'*<br><br>*Shtojca 71.1.2. Përdorimi I MS Teams* |
| **Kriteri 3.** Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit. | Nga komunikimi me stafin akademik dhe drejtuesin e njësisë bazë, rezulton se testimi përfundimtar, sipas rregullores së KU 'Logos' dhe rregullores së programit të studimit, realizohet nga një komision, i cili ka 2 anëtarë të departamentit dhe miratohet nga dekani i fakultetit.<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 4.** Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi. | Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim bazuar në rregulloret e institucionit. Pikët e akumuluara dhe vlerësimi përfundimtar janë transparente tek studentët. Nëse ka ndonjë ankesë, studentët drejtohen në njësinë bazë të cilët ndjekin procedurën e përcaktuar në rregullore.<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 5.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Nga vizita në institucion GVJ evidentoi se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback i cili jepet nga pedagogët në takim fizik ose online. Gjithashtu takimet me studentët janë të nevojshme për të këshilluar studentët dhe për ti ndihmuar ata për tu përmirësuar në të ardhmen.<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit* |

| | |
|---|---|
| | *Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 6.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik. | Bazuar në rregulloret e institucionit lektorët, asistent lektorët dhe anëtarët e komisioneve të provimit janë përgjegjës për evidentimin e plagjaturës. Stafet akademike përgjegjse bazuar në rregullore nuk tokerojnë plagjaturën në cfo formë të saj sikurse dhe kopjimin në provime dhe detyra që studentët realizojnë.<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'.* |
| **Kriteri 7.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Proçesi i vlerësimit të njohurive dhe dijeve të fituara nga studentët e këtij programi bëhet në përputhje me programin e studimit. Rezultatet e testimit i vihen në dispozicion sekretarisë mësimore brenda 5 ditëve kalendarike nga data e kryerjes së provimit nëpërmjet procesverbaleve, pasi ka përfunduar procesi i njohjes së rezultateve nga studentët.<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'.* |
| **Kriteri 8.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | Në bazë të rregulloreve të institucionit, pas shpalljes së rezultateve studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi ose të kundërshtojë rezultatin e marrë brenda dy ditëve (48 orëve). Komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e zgjidhur. Këto të dhëna janë marrë nga RVB pasi në departament nuk ka patur asnjë rast ankese apo zgjidhje të saj.<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'.* |
| **Kriteri 9.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më | Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar si dhe bazuar në rregulloret e institucionit, GVJ, konstaton se studenti e ka të sanksionuar të drejtën e ankimimit për rezultatet. Proçedura e |

| | |
|---|---|
| pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet | ndjekur për ankimim, për zgjidhjen e ankesës si dhe vendimi i marrë realizohet në afate të përcaktuara dhe siguron transparencë për palët e përfshira në process. Kjo është një procedurë por që për këtë program studimi, GVJ ju bë me dije se nuk ka patur raste.<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.7**<br><br>**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. | Programi i studimit Bsc në Menaxhim Biznesi është ndërtuar duke respektuar VKM-të në fuqi. Në dy vitet e para ky program është i njëjë me programet e tjera të Fakultetit Ekonomk. Në vitin e tretë ky program studimi ka në pjesën më të madhe të tij lëndët karakterizuese (Kategoria B), dhe është i ndryshëm nga programet e tjera. NË këtë mënyrë garantohet thellimi i njohurive, zhvillimi I aftësive profesionale dhe të veçanta për studentët.<br><br>*Shtojca nr 14. Planet mësimore* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | Plani mësimor i këtij program studimi përmban lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimeve përmbyllëse. Për të rritur aftësitë teknologjike janë përfshirë në planin mësimor lëndë të tilla si Strukturë të dhënash, Bazë të dhënash, Informatikë etj. Edhe për rritjen e aftësive gjuhësore institucioni ka përfshirë në plnin mësimor lëndë të gjuhëve të huaja anlisht dhe greqisht.<br><br>*Shtojca nr 14. Planet mësimore* |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të | Bazuar në RVB si dhe në takimin me studentët e programit, konstatuam se në fillim të semestrit, studentët marrin |

| | |
|---|---|
| paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde. | informacion për mënyrën e organizimit të lëndës, objektivat e lëndës dhe rezultatet e pritshme. Në syllabuset e lëndëve studentët gjejnë informacion në lidhje me kompetencat dhe aftësitë që marrin në lëndën përkatëse. Këtu ato njihen me temat, kohëzgjatjen e kursit, frekuentimin, mënyrën e vlerësimit, si dhe literaturën bazë dhe plotësuese si dhe me numrin e krediteve të lëndës. Në seancën e fundit të semestrit çdo pedagog realizon një përmbledhje të temave kryesore dhe analizon çështjet të ndryshme të lëndës. Gjithashtu, në grupet mësimore diskutohen çështje për përmirësimin në vazhdimësi të syllabusit si dhe çështje që kanë të bëjnë me përmirësimin në vazhdimësi të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe në mënyrë të strukturuar i paraqiten departamentit për diskutim.<br><br>*Shtojca nr 14. Planet mësimore* |
| **Kriteri 4.** Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre. | Në fund të semestrit, pedagogët e moduleve realizojnë një përmbledhje dhe rishikim të kompetencave dhe aftësive që synoheshin të arriheshin nga ana e studentëve në përfundim të modulit. Studentët orientohen në lidhje me çështjet më të rëndësishme ku do të përqëndrohet përgatitja e tyre për provimin final, strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë ky provim.<br><br>*Shtojca nr 14. Planet mësimore* |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit. | Personeli akademik angazhohet në realizimin e orëve të hapura dhe seminareve të cilat nuk janë pjesë e orëve mësimore. Temat e realizuara në këtë orë të hapura janë të ndryshme dhe lidhen me shkencën, teknologjinë, aplikime praktike e shumë të tjera.<br><br>*Shtojca nr 14. Planet mësimore*<br><br>*Shtojca br 53 Plani i aktiviteteve.* |
| **Kriteri 6.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. | Referuar planit mësimor, syllabuseve si dhe takimeve me stafin dhe studentët e programit, rezulton se në procesin e mësimdhënies organizimi i orës së mësimit i përshtatet natyrës së lëndëve dhe synon angazhimin e studentëve në mënyrë interaktive. Si rezultat i kompetencave të studentëve evidentohen konferencat studentore dhe praktikat profesionale.<br><br>*Shtojca nr 14. Planet mësimore*<br><br>*Shtojca br 53 Plani i aktiviteteve.*<br><br>*Shtojca 59. Konferenca studentore*<br><br>*Shtojca 73. Dosje e plotë e praktikës profesionale program I studimit Baxhelor në Menaxhim Biznesi* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 7.** Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara. | Personeli akademik mban në fokus në realizimin e mësimdhënies forcimin e interaktivitetit të studentëve. Diskutimet dhe puna në grup për interpretim dhe zgjidhje problemesh apo çështjesh të caktuara janë një nga shtyllat e mësimdhënies dhe mësimnxënies në institucion.<br>*Shtojca nr 14. Planet mësimore*<br>*Shtojca 19. Syllabuset e lëndëve* |
| **Kriteri 8.** Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve. | Personeli akademik ka një nga detyrat e veta kryesore të krijojë një klimë e përshtatshme për zhvillimin e ideve inovatore të studentëve. Gjithashtu studentët inkurajohen nga stafi akademik për studime më të avancuara kërkimore dhe shkecore. Kjo klimë identifikohet dhe në konferencat ku studentët marrin pjesë, në trajnimet nga Erasmus dhe në praktikat mësimore që zhvillohen. Një tjetër mënyrë është dhe angazhimi i studentëve në kryerjen e detyrave të kursit, si një detyrim i programit i ka mundësuar atyre që të kryejnë vetë studime më të thelluara kërkimore e shkencore.<br>*Shtojca nr63 Informimi i studentëve për Erasmus*<br>*Shtojca 59. Konferenca studentore*<br>*Shtojca 73. Dosje e plotë e praktikës profesionale program I studimit Baxhelor në Menaxhim Biznesi.* |
| **Kriteri 9.** Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët. | KU 'Logos' mbështet financiarisht studentët në pjesëmarrje në konferenca studentore. Institucioni mbështet interesimin, pjesëmarrjen dhe zhvillimin e aktiviteteve që promovojnë idetë novatore ku studentët e institucionit gjejnë mjedis për zhvillimin e ideve të tyre.<br>*Shtojca 59. Konferenca studentore* |
| **Kriteri 10.** Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve | Për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve stafi akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet që ka bashkëpunim institucioni. Personeli është një fasilitues i këtij procesi në lidhje me studentët, duke dhënë informacion, ndërthurur format e mësimdhënies me anë të eksperiencave më të mira të marra dhe duke këshilluar studentët.<br>*Shtojca 63.4 Informimi i studentëve për Erasmus*<br>*Shtojca nr 63.1. Student Mobility* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| Standardi III.8<br><br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike. | Procedura e provimit final dhe mbrojtjes së diplomës është bazuar në rregulloret e intitucionit. Këto dokumente përpara aprovimit janë pjesë e diskutimit me studentët dhe pedagogët e programit të studimit. Keto procedura janë publike për studentët përara zhvillimit të provimee finale dhe mbrojtjes së temave të diplomës.<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës. | Nga shqyrtimi i dokumentacionit si dhe nga takimi me studentët rezultoi se strukturat përgjegjëse të programit të studimit Bsc në Menaxhim Biznesi dhe personeli akademik i departamentit, asistojnë studentët duke vënë në dispozicion të tyre të gjitha informacionet e nevojshme në funksion të përgatitjes dhe mbrojtjen e diplomës.<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | Referuar rregulloreve të institucionit për studentët të cilët kryejnë provim final, stafi akademik përgatit një databazë petjesh të cilat pasi miratohen në department i paraqiten studentëve. Komisioni i cili është përgjegjës për realizimin e provimit final, garanton që për studentët testohen njohuritë e marra përgjatë tre viteve akademike sipas peshës dhe rëndësisë përkatëse. Databaza e pyetjeve ndërtohet nga databazat e lëndëve përkatëse dhe secili pedagog është pjesë për realizimin e saj.<br><br>*Shtojca 74.2 Procesverbal Departamenti i Menaxhimit miratimi i pyetjeve për provimin final 2021-2022* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave. | Departamenti i menaxhimit në bashkëpunim me FE, kanë monitoruar dhe asistuar vazhdimisht studentët e programit të studimit Bsc në Menaxhim Biznesi, në aftësimin e tyre për realizimin me sukses të detyrimeve te programit mësimor. Pedagogët punojnë ngushtë me studentët për aftësimin e tyre në analizën dhe gjetjen e literaturës së duhur sipas profilit dhe për vëzhgime në mjedisin e biznesit, kur nevojiten të tilla. Personeli akademik ndjek studentët përgjatë gjithë procesit të hartimit të temës së diplomës deri në mbrojtjen e saj.<br><br>*Shtojcat 68- Komunikime me studentët për temat e diplomës* |
| **Kriteri 5.** Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | Personeli akademik ka për detyrë lehtësimin e punëve të stuentëve lidhur me metodologjinë e temave të diplomave. Personeli ndihmon studentët për modelimin e problemit të kërkimit, përgatitjen e pyetsorëve dhe analizën e të dhënave bazuar në temat dhe fushat e përzgjedhura nga studentët.<br>*Shtojcat 68- Komunikime me studentët për temat e diplomës* |
| **Kriteri 6.** Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | Referuar RVB-së, GVJ konstaton se udhëheqësi i diplomës pas përcaktimit të programit të punës së studentit, për realizimin e diplomës si dhe afatet e përfundimit të saj, është në kontakt të vazhdueshëm me studentin për përpunimin e të dhënave dhe nxjerrjen e rezultateve. Në fund udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studenti, garanton origjinalitetin e punimit dhe cilësinë e rezultateve si dhe lejon mbrojtjen e tij, duke e nënshkruar. Mendimi i udhëheqësit shprehet nëpërmjet vlerësimit duke plotësuar një formular i cili përmban elementët e vlerësimit dhe vlerësimin total.<br>*Shtojcat 68- Komunikime me studentët për temat e diplomës*<br>*Shtojca nr.10. Formati i punimit të Diplomës Bachelor dhe formati i vlerësimit të udhëheqësit.* |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Bazuar në rregulloret e institucionit, në përfundim të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë për të cilën bëhet me dije në ditën e mbrojtjes së diplomës. Studentët që vlerësohen me notë kaluese në mbrojtjen e diplomes mbyllin ciklin e parë të studimeve Bsc në Menaxhim Biznesi.<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'* |

<table>
<tr><td colspan="2">Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</td><td colspan="4">Bazuar në rregulloret e institucionit, student pajiset me diplomë dhe supplement diplome sipas standarteve të miratuara nga ministry pas përfundimit të studimeve dhe pas mbrojtjes së temës së diplomës dhe vlerësimit të saj me notë kaluese.<br><br>Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.<br><br>Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit<br><br>Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'<br><br>Shtojca 15.1. Diploma Bachelor Menaxhim Biznesi<br><br>Shtojca 15.2 Suplement MB-2022</td></tr>
<tr><td colspan="2">Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</td><td colspan="4">Në përfundim të studimeve studenti merr diplomën se bashku me suplementin. Institucioni, me kërkesë të studentit, i ve në dispozicion një kopje te plote zyrtare te programit të studimit. Kjo procedurë është e bazuar në rregulloret e institucionit.<br><br>Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.<br><br>Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit<br><br>Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'<br><br>Shtojca 15.1. Diploma Bachelor Menaxhim Biznesi<br><br>Shtojca 15.2 Suplement MB-2022</td></tr>
<tr><td colspan="2">Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen</td><td colspan="4">Institucioni ruan për një periuhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet apo konfirmon rast pas rasti informacione për studentin nëse këto informacione kërkohen nga student.<br><br>Shtojca nr.62. Rregullore Arkiv-Protokoll</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td></td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td colspan="2">Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td colspan="2">X</td></tr>
</table>

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi IV.1**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ. | GVJ u njoh me dokumentacionin e paraqitur në dosjen e vetë vlerësimit (DVV) ku specifikohet se informacioni në lidhje me anëtarët e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit ruhen në dy nivele. Të dhënat në lidhje me stafin akademik fillimisht mblidhen dhe depozitohen pranë njësisë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit (në këtë rast Departamenti i Menaxhimit). Në nivelin e dytë, të dhënat në lidhje me stafin, si akademik, ashtu edhe atë drejtues dhe ndihmës mësimor, mblidhen dhe administrohen nga Dega e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivës, e cila administron dosjet e plota për cdo anëtar të personelit. Gjatë vizitës në zyrën e BNJ nuk u evidentuan mangësi në mos ruajtjen e dokumentacionit (diploma apo ekuivalentime) në origjinal apo të noterizuar në dosjet respektive të të dhënave të personelit akademik.<br><br>*Shtojca nr.62. Rregullore Arkiv-Protokoll* |
| **Kriteri 2.** Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit. | Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit si edhe gjatë vizitës në Institucion, GVJ konfirmoi formalizimin dhe funksionimin e procedurave për rekrutimin e personelit akademik. Këto procedura paraqiten në përputhje me kërkesat ligjore. Institucioni angazhon, në varësi të nevojave të tij staf akademik me kohë të plotë, me kohëzgjatje të caktuar ose me kohëzgjatje të pacaktuar, si edhe staf akademik me kohë të pjesshme sic u verifikua nga tabelat e të dhënave në RVB. Bazuar në RVB, procesi i seleksionimit të kandidateve kalon në disa faza, procesi kryhet në mënyre transparente dhe aplikantët njoftohen në secilën fazë, deri në pranimin në punë të kandidatëve të përzgjedhur. Gjatë vizitës në zyrën e BNJ u kërkua verifikimi për 2 rekrutimet më të fundit (PAE) të na vendosej në dispozicion dokumentacioni që ka shoqëruar gjithë këtë proces, dhe u konstatua se në dosjet respektive ishin ruajtur dokumentat e kërkuara.<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 3.** Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për | GVJ shqyrtoi me kujdes dokumentacionin e dorëzuar si edhe njoftimet publike në faqen e internetit të Institucionit për disa njoftime për vende pune të publikuara në faqen e internetit. GVJ |

| | |
|---|---|
| rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike. | konstaton që në kriteret specifike të përcaktuara në rregullore për vlerësimin e aplikantëve për vendet vakante të personelit akademik pa grade shkencore nuk ka një përcaktim të qartë në lidhje me nivelin e rezultateve të shkollimit që kërkohet nga aplikantët. Pra, GVJ këshillon IAL se vendosja e një kriteri që lidhet me mesataren e përbashkët të rezultateve të diplomës Bachelor dhe Master do të ishin shumë të rëndësishme për të garantuar përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe që do të garantonin rekrutimin e personelit akademik cilësor dhe si rrjedhim rritjen e cilësisë së këtij program studimi. |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Sipas GVB procedura e rekrutimit fillon me konstatimin e vendeve vakante nga ana e njësisë bazë e cila harton një Kërkesë për Rekrutim Stafi akademik drejtuar dekanit dhe rektorit. Njëkohësisht, njësitë bazë specifikojnë edhe kriteret për përzgjedhjen e kadidaturave, kritere që variojnë sipas nevojave specifike të programit të studimit. Kriteret i dërgohen zyrës së BNJ dhe pasi përpunohen prej saj, përcillen te rektori i cili i miraton ato. Shpallja e njoftimeve për vendet vakante publikohet jo vetëm në ëeb faqen e Institucionit por sipas tyre edhe në rrjete sociale e deri në televizione dhe periodikë. Rektori ngre një komision të kryesuar nga dekani i njësisë kryesore të programit të studimit, i cili është përgjegjës për procedurën e rekrutimit e cila kalon në dy faza: faza e parë lidhet me shqyrtimin paraprak të kërkesave të kandidatëve që janë dorëuar pranë zyrës së BNJ, kurse faza e dytë është intervistimi i kandidatëve që plotësojnë kriteret e fazës së parë. Komisioni përgatit një raport vlerësimi të kandidatëve e cila i përcillet Rektorit dhe punësimi bëhet pasi merret miratimi i Rektorit. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.2**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficente dhe efektive** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë | Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi në vend kushtet e punës dhe mjedisin që i mundësonte personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ kryerjen e detyrave të tyre përkatëse. Mjediset e Institucionit gjenden në një vendndodhje të mirë në qytetin e Tiranës, lehtësisht të aksesueshme. Zyrat ishin të pajisuar me mobilimin dhe pajisjet teknologjike të nevojshme dhe të gjitha ambientet e Institucionit mbuloheshin nga rrjeti ëireless që ofronte |

| | |
|---|---|
| profesionale. | Internet për stafin dhe studentët. |
| **Kriteri 2.** Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit. | GVJ shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar në DVV dhe konstatoi se në dokumentat bazë, përmenden synime dhe objektiva të mirëfilla të Institucionit për përmirësimin e stafit akademik. Sipas RVB dhe evidencave (tabelat 19 dhe 20) mund të konstatojmë se kërkimi shkencor i stafit, si edhe marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura mes Institucionit dhe partnerëve të rëndësishëm akademikë dhe të biznesit, tregojnë se ka aktivitete kërkimore dhe bashkëpunime shkencore. Gjithashtu, nga intervistat me përgjegjësin e departamentit, Zv.Dekanin dhe stafin akademik, GVJ u informua se përparësi në financim kanë personat që mbrojnë doktoraturën, dhe si lehtësim mund të kenë reduktim oresh, ose edhe financime për pjesëmarrje në konferenca shkencore.<br><br>*Shtojca nr 34.1 Marrëveshje bashkëpunimi KU Logos me IAL brenda dhe jashtë vendit*<br><br>*Shtojca nr 63.3 Staff Mobility*<br><br>*Shtojca nr79. Trajnime nga Institucioni për mësimdhënien* |
| **Kriteri 3.** Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor. | Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar në DVV, si dhe gjatë takimeve me pedagogët dhe Përgjegjësin e Departamentit GVJ konstatoi se Institucioni organizon vazhdimisht aktivitete në kuadër të kualifikimit të mëtejshëm profesional të personelit akademik, për përmirësimin e metodave të mësimdhënies, dhe së fundmi edhe në kuadrin e përdorimit të teknologjive të reja të mësimdhënies. Bien në sy trajnime për përdorimin e platformës së mësimit online G Suite dhe sistemet "Student Management System". Plani i trajnimeve për stafin akademik hartohet në fillim të vitit akademik dhe të pyetur mbi nivelin e zbatueshmërisë së tij, stafi u shpreh se ishin trajnuar nga Institucioni.<br><br>*Shtojca nr79. Trajnime nga Institucioni për mësimdhënien* |
| **Kriteri 4.** Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë. | Mbështetur tek dokumentat e paraqitura në DVV (Tabelat 1 dhe 2 në evidencën 18: "Përmbledhëse e Tabelave për programin e studimit") si dhe nga takimet në vizitën në institucion, GVJ konstaton se Departamenti iMenaxhimit, i cili është edhe njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, ka një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të këtij programi, duke përmbushur edhe kërkesat ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të stafit.<br><br>Sipas GVB, ngarkesa mësimore dhe shpërndarja e saj tek PAE dhe PAK dëshmon për një angazhim të personelit akademik për plotësimin e objektivave të programit të studimit |
| **Shkalla e përmbushjes së** | **Përmbushet** **Përmbushet** **Përmbushet** |

| standardit | përmbushet | pjesërisht | kryesisht | plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi IV.3**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | Mbështetur në dokumentacion, GVJ konstaton se KU 'Logos' e zhvillon veprimtarinë mësimore në ndërtesat e veta të cilat kanë një infrastrukturë të kompletuar, komode dhe të përshtatshme për grupet mësimore të këtij programi studimi dhe numrin e studentëve në to, në përputhje me natyrën specifike të këtij programi dhe moduleve të tij. Në kampus ka edhe ambiente në shërbim të mësimit si bibliotekë, sallë interneti, etj. Gjatë vizitës në institucion si dhe mbështetur tek dokumentacioni i dorëzuar në DVV (Evidenca 18, tabela 16), GVJ konstaton se në funksion të fakultetit / departamentit ka në dispozicion salla për leksione dhe për seminare, 1 sallë interneti, 1 sallë për bibliotekë dhe laboratorë kompjuterësh përvec ambienteve të tjera mbështetëse për programin si mjedis për fotokopje, zyra informimi, zyra për stafin dhe drejtuesit, etj. |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | Gjatë vizitës në institucion si dhe mbështetur tek dokumentat në DVV (Evidenca 18, tabela 16), GVJ konstatoi se ambientet mësimore ishin të pajisura me videoprojektorë, sisteme audio, lidhje interneti ëireless dhe tabela inteligjente që krijojnë kushtet për realizimin cilësor të procesit mësimor teorik e praktik. Laboratorët kanë poste të pajisura me PC dhe programet përkatëse te nevojshme për zhvillimin e punës laboratorike. |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave | Në funksion të programit të studimit ka në dispozicion laboratorë informatike (Tabela 16, evidenca 18). Ata jane te pajisur me kompjutera ku janë instaluar programe profesionale si: Alpha dhe Financa 5, SPSS apo programi i Business English, të cilat mund të ndihmojnë dhe aftësojnë studentët nga ana praktike. Ato janë në dispozicion të studentëve për t'u shfrytëzuar për realizimin e detyrave të kursit apo punimet e diplomës. Gjatë vizitës në institucion, si dhe në bisedat me studentët dhe pedagogët GVJ konstatoi se këta laboratorë janë të pajisur me programe |

| | |
|---|---|
| formues të programit të studimit në tërësi. | profesionale në përputhje me natyrën dhe modulet e këtij programi studimi. Shfrytëzimi i këtyre laboratoreve nuk ishte i kufizuar vetëm gjatë orarit mësimor, por edhe sipas kërkesave dhe nevojave të studentëve të programit të studimit. |
| **Kriteri 4.** Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron. | Këta laboratorë janë të pajisur me programe profesionale në përputhje me natyrën dhe modulet e këtij programi studimi. Shfrytëzimi i këtyre laboratoreve nuk ishte i kufizuar vetëm gjatë orarit mësimor, por edhe sipas kërkesave dhe nevojave të studentëve të programit të studimit. |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. | Për këtë kriter, në RVB të përgatitur nga Institucioni listohen disa mundësi të zhvillimit të praktikave profesionale apo veprimtarive të tjera aplikative praktike në bashkëpunim me institucione të tjera. Në dokumentacionin e dorëzuar në DVV, GVJ gjen disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione akademike dhe subjekte biznesi të cilat mundësojnë zhvillimin e praktikave nga ana e studentëve. Marrëveshjet e bashkëpunimit për praktikat profesionale janë hartuar me qëllim që studentët përvec anës teorike të mësojnë dhe anën praktike. Po kështu, gjatë vizitës në Institucion, studentët konfirmuan angazhimin e KU 'Logos' për praktikat e tyre<br><br>*Shtojca nr 42. Dokumentacioni në lidhje me infrastrukturën e KU 'Logos'* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi IV.4**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | Sipas verifikimeve të dokumentacionit (tabela 16 në RVB) të kryera nga GVJ, Institucioni raporton se disponon salla për biblioteka. Këto salla, sic u konstatua në vend, në fakt ishin ambiente të përshtatshme për lexim e studim, por bibliotekë e mirëfilltë ishte vetëm një hapësirë kryesore e vetme. GVJ gjatë vizitës në Institucion, konstatoi se salla e Bibliotekës ishte e pajisur me ndricim natyral, me sistem ngrohje/ftohje, me rafte, poste me kompjutera, dhe orari i funksionimit ishte 8.30 – 19.30. Kjo sallë |

| | |
|---|---|
| | është në dispozicion të të gjithë studentëve<br><br>*Shtojca nr 42. Dokumentacioni në lidhje me infrastrukturën e KU 'Logos'*<br><br>*Shtojca nr 45.2 Strategjia e bibliotekës 2019-2023*<br><br>*Shtojca 45.1 Lista e titujve në bibliotekë për Departamentin e Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 45.4 Fushata-Një libër më shumë për bibliotekën e Logosit.* |
| **Kriteri 2.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Sipas RVB të përgatitur nga Institucioni referohet se në Bibiliotekat e Institucionit mund të gjenden fizikisht tituj librash. Tekstet në bibliotekë janë në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të tjera, kryesisht atë angleze. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi tituj në bibliotekë të cilët janë të shumte.<br><br>***GVJ sugjeron shtimin dhe zgjerimin e tyre, pavarsisht se për këtë program studimi mund të përdoren libra dhe literaturë online e cila gjendet me bollëk ne librarine elektronike jstore.*** |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit. | Sipas RVB të përgatitur nga Institucioni referohet se në bibiliotekën online, ka mundësi aksesi deri në 25.000 tituj librash. Ky fond librash, bashke me ato qe ofron Edëard Elgar Publishing, Cobiss.al dhe Springer books, jane ne dispozicion te personelit dhe studenteve pa pagese, ne funksion te punes mesimore dhe shkencore sipas fushave te interesit.<br><br>*Shtojca nr 42. Dokumentacioni në lidhje me infrastrukturën e KU 'Logos'*<br><br>*Shtojca nr 45.2 Strategjia e bibliotekës 2019-2023*<br><br>*Shtojca 45.1 Lista e titujve në bibliotekë për Departamentin e Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 45.4 Fushata-Një libër më shumë për bibliotekën e Logosit.* |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve. | Gjatë vizitës në sallat e bibliotekave të universitetit, GVJ konstatoi se në këto ambiente ofrohet pa kufizim aksesi në Internet nëpërmjet rrjetit ëireless që i jep mundësi studentëve të kërkojnë në bibliotekën online<br><br>Kjo bibliotekë kishte vetëm 11 poste kompjuterike GVJ është i mendimit se ky është një numër shumë i vogël në krahasim me numrin e studentëve që mund të aksesojnë bibliotekën të të njëjtën kohë. |

| | |
|---|---|
| | ***Sugjerojmë shtimin e kompjuterave në bibliotekë në përshtatje me nevojat e studentëve.***<br><br>*Shtojca nr 42. Dokumentacioni në lidhje me infrastrukturën e KU 'Logos'*<br><br>*Shtojca nr 45.2 Strategjia e bibliotekës 2019-2023*<br><br>*Shtojca 45.1 Lista e titujve në bibliotekë për Departamentin e Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 45.4 Fushata-Një libër më shumë për bibliotekën e Logosit.* |
| **Kriteri 5**. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit. | Në RVB të përgatitur nga Institucioni, për këtë kriter deklarohet se angazhohet në nxitjen e njësive kryesore dhe njësive bazë që cdo vit të paraqesin kërkesat e tyre për tituj të rinj në funksion të përmbushjes së objektivave të programeve të studimit që secila prej tyre ofron. Një pjesë e titujve të rinj të shtuar së fundmi në bibliotekë janë edhe botime të personelit akademik të Institucionit. Në DVV, nga ana e GVJ nuk u konstatua asnjë plan konkret apo qoftë edhe model kërkese për shtimin e titujve të rinj në bibliotekë. Të pyetur gjatë vizitës në Institucion, stafi akademik u shpreh se kerkesat e pedagogeve për tekste të reja mblidhen nga shefi i departamentit i cili ia percjell dekanit dhe ky administratorit. Pedagogët u shprehën se kanë mundësi të kenë tekstet e duhura dhe në kohë.<br><br>Meqënëse gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në DVV apo referencave në RVB për këtë kriter, GVJ nuk gjeti ndonjë dokument që vërteton ekzistencën dhe për më tepër implementimin e një plani të detajuar të pasurimit të zërave të bibliotekës, ***sugjerohet hartimi i një plani të detajuar vjetor për shtimin e literaturës që lidhet me këtë program studimi.*** |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | Salla e Bibiotekës së Institucionit konsiderohet njësi ndihmëse në funksion të arritjes së objektivave primare të programeve të studimit dhe si të tilla oraret e tyre duhet të koordinojnë me oraret e ofrimit të mësimit në programet e studimit. Ajo ishte gjithashtu e pajisur me printer dhe fotokopje në funksion të kërkesave të studentëve. Oraret e funksionimit të sallave në periudha normale ishin nga ora 8.30 – 19.30. Ajo qendron e hapur ne fundjave per sezonin e provimeve. Nga ana e GVJ kjo fashë orare konsiderohet e mjaftueshme për të përmbushur nevojat e procesit mësimor kjo gjë u konfirmua edhe nga vetë studentët e programit të studimit gjatë vizitës në Institucion.<br><br>*Shtojca nr 42. Dokumentacioni në lidhje me infrastrukturën e KU 'Logos'*<br><br>*Shtojca nr 45.2 Strategjia e bibliotekës 2019-2023* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *Shtojca 45.1 Lista e titujve në bibliotekë për Departamentin e Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 45.4 Fushata-Një libër më shumë për bibliotekën e Logosit.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.5**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | Në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë, sekretaria mësimore, ka ndërtuar gjithë sistemin e brendshëm të menaxhimit të informacionit për studentët që nga momenti i rregjistrimit në përputhje me rregullat e MAS, deri në përfundim të studimeve dhe pajisjen me diplomë dhe suplementin e diplomës.<br><br>Gjatë vizitës në sekretari, dosjet fizike dhe "dosjet elektronike", rregjistrat, proces-verbalet, rregjistri themeltar dhe çdo dokument tjetër që është nën përgjegjësinë e zyrës ishin lehtësisht të verifikueshme dhe mjaft mirë të sistemuara. Sistemi ofrohet në gjuhën shqipe. Sistemi ka akses të dedikuar dhe të vecantë për stafin akademik dhe për studentët dhe funksionon edhe me akses nga jashtë institucionit.<br><br>Sic u informuam gjatë vizitës në Institucion, ky sistem kishte përdorim të gjerë nga ana e stafit dhe studentëve dhe atyre u ofroheshin trajnime përgatitore për përdorimin e sistemit. Sistemi SMS përdorej gjerësisht edhe nga ana e stafit administrativ. Të dhënat mund të përditësohen elektronikisht, përveçse mbahen në hard-copy në regjistrat e notave dhe të diplomave në Sekretarinë Mësimore. Ndërsa, të dhënat personale të studentëve hidhen në regjistrin e amzës (regjistri themeltar) dhe të gjitha regjistrat në formë të shkruar dhe në version elektronik, janë në administrimin e Sekretarisë Mësimore.<br><br>*Shtojca 71..2 Përdorimi i MS Teams* |
| | *Shtojca nr 42. Dokumentacioni në lidhje me infrastrukturën e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 2.** Sistemi i | Referuar RVB, strukturat përgjegjëse për ruajtjen e dokumentacionit |

| | |
|---|---|
| brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | të personelit akademik e ndihmës akademik janë Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arshiva. |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | Sikurse referohet në RVB të përgatitur nga Institucioni dhe sic edhe u konfirmua gjatë vizitës në Institucion, nga ana e GVJ, sistemi SMS ofron akses të dedikuar në dokumentacionet e nevojshme duke pasur dy panele aksesi: paneli i dedikuar për stafin akademik dhe ndihmës dhe paneli i dedikuar për studentët. Nëpërmjet sistemit SMS, stafi akademik mund të realizojë shumë funksione të ofruara nga modulet e ndryshme të sistemit, si psh., modifikojë të dhënat personale në modulin „profili im", të kontrollojë klasat mësimore, të realizojë hedhjen e notave dhe të kontrollojë kërkesat për rishikim, të kontrollojë planet mësimore për cdo lëndë, etj.<br><br>*Shtojca 71..2 Përdorimi i MS Teams*<br><br>*Shtojca nr 42. Dokumentacioni në lidhje me infrastrukturën e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. | Sipas të dhënave të referuara në RVB, sistemi mundëson ndërveprimin mes aktorëve të institucionit duke lejuar hapjen dhe menaxhimin e adresave personale të emailit. Më shumë informacion në lidhje me sistemin, GVJ mori gjatë vzitës në Institucion.<br><br>Gjithashtu, u konstatua se për të menaxhuar në mënyrë sa më efektive procesin mësimor online, gjatë vitit akademik 2020-2021 Institucioni implementoi edhe platformën G Suite me komponentët Google Classroom dhe Google Meet.<br><br>Gjatë vizitës në Institucion u konfirmua se kjo platformë ishte e llojit: "academic account" duke ofruar facilitate të konsiderueshme për pjesëmarrësit.<br><br>*Shtojca 71..2 Përdorimi i MS Teams*<br><br>*Shtojca nr 42. Dokumentacioni në lidhje me infrastrukturën e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson | Sistemi i menaxhimit të studentëve është një sistem që mundëson kontrollin në kohë reale të frekuentimit të mësimit nga ana e studentëve dhe e stafit. Kjo referohet në RVB të përgatitur nga institucioni por konstatohet edhe në evidencën "Manual përdorimi i SMS për pedagogët". Megjithatë, sic edhe u konfirmua gjatë vizitës |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. | në Institucion sistemi nuk mundësonte gjenerimin e raporteve individuale dhe të dhëna në kohë reale përtej atyre që kanë të bëjnë me mësimdhënien. | | | |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe. | Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik të përfshirë në të, aktivitetet e ndryshme të departamentit përgjegjës për këtë program studimi, gjenden të qarta dhe të detajuara në faqen e ëeb-it të universitetit (sipas disa referencave në links më poshtë). GVJ konstatoi se informacionet në lidhje me stafin e angazhuar në këtë program studimi janë të kufizuara dhe për shumë prej tyre mungon një bio e shkurtër prezantuese. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.6**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | Nga shqyrtimi i dokuentacionit të dorzuar në DVV, KU "Logos" përcakton në Statutin pikat që lidhen me buxhetin dhe aspektet financiare<br><br>Sipas statutit buxheti hartohet nga Administratori i Universitetit bazuar në një plan afatmesëm 3 vjeçar, Planin Strategjik të Innstitucionit dhe nga propozimet e marra nga strukturat e Njësive Kryesore dhe Njësive Bazë. Ai aprovohet nga Bordi i Administrimit i dhe është i realizuar në përputhje me standardet ligjore.<br><br>Evidencë për informacione financiare të lidhura me të ardhurat dhe kostot gjendet në DVV si pjesë e të dhënave financiare institucionale (evidenca 17), dhe në (tabelën 18 në evidencën 8). Vlen të theksohet se informacioni i përfshirë në këto dy evidenca është shumë i përmbledhur në rang institucional dhe në asnjë moment nuk i referohet vetëm programit të studimit në fjalë. Vec kësaj, në asnjë nga këto evidenca nuk u gjetën informacione në lidhje me kostot specifike të programit të studimit; apo informacion për pasurimin e bibliotekës, etj.<br><br>*Dokumenti 02: Statuti I KU Logos* |
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në | |

| | |
|---|---|
| bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij. | |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare. | Sipas RVB, auditimi i gjendjes së financimit dhe efektiviteti financiar të institucionit përveç organizmave të auditit të KLSH dhe MAS, ka dhe sektorin e auditit të brendshëm nën varësinë e Bordit të Administrimit i cili kryen në mënyrë periodike auditimin dhe raporton përpara Bordit të Administrimit. |
| **Kriteri 4.** Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. | Për të analizuar shkallën e përmbushjes së këtij kriteri, GVJ u mbështet në analizën e RVB dhe tabelave mbështetëse të saj, si edhe dokumentacionit shoqëruese, pjesë e DVV.<br><br>Sipas RVB të përgatitur nga Institucioni, kontrolli buxhetor realizohet nga Administratori dhe synon të garantojë përdorimin eficient të burimeve të KU "Logos, në funksion të arritjes së objektivave të tij. Sipas DVV, detyrë e Administratorit është pikërisht ndjekja dhe kontrolli i zbatimit të buxhetit vjetor dhe paraqitja në përfundim të cdo viti akademik para Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik të raportit të veprimtarisë financiare. Në vijim të analizës së shkallës së përmbushjes së këtij kriteri, nga shqyrtimi i *(tabelës 18 në evidencën 8)*, GVJ konfirmon se Institucioni ka paraqitur nja plan financiar institucional. |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen. | Me miratimin e buxhetit nga Bordi i Administrimit, si një përmbledhje e harmonizuar e detajuar dhe gjithëpërfshirëse e të gjithë strukturave të universitetit në mbështetje të plotë të nevojave të gjithanshme për realizimin e misionit dhe objektivave të universitetit në tërësi dhe programeve të studimit në veçanti, garantohet qëndrueshmëria financiare e gjithë periudhës së zhvillimit të programit të studimit. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | Programi i studimit është konceptuar dhe zhvillon veprimtarinë e tij në përputhje të plotë me Ligjin e Arsimt të Lartë Nr 80/2015 dhe VKM Nr 41 dt 24.01.2018, për Elementët e Programit të Studimit të Ofruar nga ILA-të, si dhe një sërë dokumentash ligjorë dhe rregullatorë si:<br>*Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br>*Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br>*Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | Të gjitha këto akte mbulojnë të gjithë veprimtarinë e punës së njësisë kryesore dhe bazë nga hyrja e studentëve në programin Bachelor, deri në diplomimin e tyre.<br>Studentët që nga momenti i hyrjes deri në dalje nga studimet gëzojnë të drejtën të trajtohen në mënyrë të njëjtë në të gjithë elementët dhe strukturat përgjegjëse të njësisë kryesore dhe bazë të programit, të marrin pjesë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin dhe Rregulloret në një sërë organesh kolegjiale nga Senati, në proceset e akreditimit përmes pjesëmarrjes në grupet e Vlerësimit të Brendshëm, në Këshillin e Etikës, etj.<br>Studentët, gëzojnë të drejtën e votës në zgjedhjet për trupën drejtuese të departamenteve / fakulteteve dhe universitetit si dhe përzgjidhen përmes votës së shokëve të tyre në Qeverinë Studentore dhe Këshillat Studentorë.<br>Studentët gëzojnë gjithashtu të drejtën të përfitojnë bursa studimi, bursa Erasmus, të përfshihen në projekte, të marrin pjesë në |

| | |
|---|---|
| | aktivitete e seminare extracurriculare, etj.<br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 3.** Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | KU "Logos" bën të aksesueshme në faqet e tyre zyrtare në internet të gjithë informacionin që ndihmon të gjithë të interesuarit (aplikantët për studime dhe studentët aktuale) për të marrë vendime dhe kuptuar proceset. Krahas informacioneve që kanë të bëjnë me aspektet rregullatore të universitetit dhe fakultetit, që ndihmojnë studentët për të kuptuar gjithë procesin nga aplikimi, përzgjedhja, rregjistrimi, transferimi dhe njohja e krediteve, diplomimi, në ËEB gjenden programet e studimit, departamentet, stafi akademik dhe shumë informacione të tjera përshirë dhe email e kontaktit të pedagogëve.<br>Në këtë link të ËEB studentët gjejnë të gjitha informacionet e nevojshme për jetën e tyre studentore, si dhe shumë nga procedurat, formularët për praktikën dhe diplomën<br>http://ëëë.kulogos.edu.al/al/index.html<br>Në ËEB, Departamenti i Menaxhimit përgjegjës për programin e studimit publikon të gjitha thirrjet në interes dhe për studentët. Një dokument tjetër i rëndësishëm për orientimin e kandidatëve që duan të studjojnë në KU "Logos" është Guida e Studentit. |
| **Kriteri 4.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve. | Kriteret e pranimit, bazohen kryesisht më Ligjin e Arsimit të Lartë, në rregulloren e universitetit, kodin e etikes, dhe tek vendimet dhe udhezimet tek kuotat e pranimit. Institucioni informon përpara fillimit të cdo viti akademik, për kriteret dhe procedurat që kryen në perzgjedhjen e aplikanteve<br>Departamenti i Menaxhimit formulon në muajin Dhjetor deri më dt. 10 kriteret shtesë dhe kuotat e pranimit. |
| **Kriteri 5.** Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj. | |
| **Kriteri 6.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun | Faqja e internetit **http://www.kulogos.edu.al/al/index.html**<br>ka të gjithë informacionin e duhur dhe gjithashtu prodhon dhe vë në dispozicion të publikut dhe material të tjera të cilat japin informacion |

| | |
|---|---|
| dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. | mbi programet, procedurat, aplikimin, rregulloren e programit etj. |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.2**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | Në Rregulloren e e programit të studimit Bsc. në Menaxhim Biznesi. pasqyrohen procedurat e përparimit akademik. Në nenin 22 të Rregullores së Programit të Studimit, përcaktohen elementët e vlerësimit të vazhduar të studentëve dhe pesha që zë provimi ndërmjetëm dhe përfundimtar. Studenti është kalues nëse ai ka mbledhur 50% të pikëve në provimin ndërmjetës dhe atë përfundimtar.<br><br>Në Rregulloren e programit te studimit përcaktohen kriteret e kalimit nga nje vit ne tjetrin, ndërsa në nenin 53 numri i riprovimeve që studenti ka të drejtë të hyjë. Gjithashtu, në Rregullore i referohen procedurës së ndërprerjes së studimeve nisur nga arsyet për ndërprerjen e studimeve, autoriteti që ka të drejtën e miratimit, gjithashtu qartësohet si bëhet përditësimi i dijeve të studentit pasi ai rikthehet për të vijuar studimet. Bazuar në Statutin, Rregulloren e Programit të Studimit përcaktohet procedura e realizimit të punimit të Diplomës dhe sezonet që student mund ta mbrojë atë. Informimi studentëve për procedurat e përparimit akademik bëhet përmes disa formave: në klasë në ditët e informimit; në ËEB e FEUT, në Guidën e KU "Logos" dhe nga çdo pedagog në javën e parë, por dhe më pas në mësim në përputhje me silabuset e lëndëve.<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. në "Menaxhim Biznesi".*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e | Një nga përfitimet më të rëndësishme të Procesit të Bolonjës, është mobiliteti studentëve brenda dhe jashtë vendit. UT bazuar dhe në Ligjin Nr 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, në |

| | |
|---|---|
| njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | Statutin e tij përkatësisht Neni 109 dhe 112 ka përcaktuar kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve dhe të transferimit të tyre nga një institucion i arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit. Në Rregulloren e Universitetit në kapitull 3 të emërtuar "Ekuivalentimi, tranferimet dhe ndryshimi i sistemit të studimeve" përmes një numri nenesh përcaktohen dhe qartësohen: Ekuivalentimi; Lloji i transferimeve; Procedura e Kërkesës, Propozimi dhe Miratimi i Transferimit; Ekuivalentimi.<br><br>Si rregull, Drejtuesi i departamentit përcakton komisionin e ekuivalentimit i cili shqyrton të gjitha kërkesat që vijnë qoftë për transferimet, programe të dytë studimi apo është një kërkesë ligjore në kuadër të njohjes së diplomave të huaja.<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | Në Rregulloren e Programit të Studimit përcaktohen të gjitha modalitetet e vlerësimit të vazhduar, nga detyrat e kursit, detyrat e shtëpisë, provim i ndërmjetëm dhe provim përfundimtarr, si dhe elemëntë procedurialë që kanë të bëjnë me të drejtën e studentëve për të hyrë në provim dhe për t'u ankimuar në lidhje me rezultatin. Gjithashtu, në silabuset e çdo lëndë jepet mënyra e kontrollit të dijeve dhe si rregull në orën e parë të çdo lëndë pedagogu qartëson studentët për mënyrën e vlerësimit. Natyrisht, eksperienca është e tillë që dhe në periudhat ndërmjetëse që lidhen me afatet e dorëzimit të detyrave apo para provimeve studentët rikujtohen për rregullat, procedurat, kufizimet dhe të drejtat e tyre.<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 4.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | Në Rregulloren e Programit përcaktohet që diplomimi bëhet përmes temës së diplomës që ka karakter kërkimor dhe aplikativ, mbështetur në Udhëzuesin për Temën e Diplomës.<br><br>Studenti ka të drejtë të propozojë udhëheqësin e tij, miratimi bëhet nga drejtuesi i departamentit. Vlerësimi i temës se diplomës bëhet nga udhëheqësi dhe anëtarët e komisionit të diplomimit. Departamenti ka përcaktuar gjithashtu një template (format) të punimit të temës së diplomës. Si rregull mbrotja e diplomës është e hapur dhe pas prezantimit anëtarët e Komisionit dhe të pranishëm të tjerë gëzojnë të drejtën e bërjes së pyetjeve. Gjatë vizitës në |

| | |
|---|---|
| | institucion një nga diskutimet me stafin e departamentit ishte si sigurohet origjinaliteti i temës se diplomës. U dakordësuam që kjo mbetet një çështje shumë e diskutueshme, ku përtej aspekteve proceduriale dhe të integritetit të pedagogut, e rëndësishme është kultura e institucionale në këtë drejtim.<br><br>*Shtojcat 68- Komunikime me studentët për temat e diplomës*<br><br>*Shtojca nr.10. Formati i punimit të Diplomës Bachelor dhe formati i vlerësimit të udhëheqësit.* |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. | Ka tre rrugë të informimit të aplikantëve për studimet:<br><br>- E para përmes ËEB, bazuar në politika të caktuara të marketingut që universiteti ka të përcaktuara në Statutin e tij;<br>- Së dyti, Departamenti i Menaxhimit ka të formulur një dokument mbi "Politikat e marketingut të programit të studimit" ku identifikohen disa rrugë nga bursat, tek panairet, këshillimi i karrierës, konkurset, mbështetja e sipërmarrjes së studentëve. Gjatë vizitës në institucion, drejtuesja e departamentit u shpreh që departamenti bën seanca informuese me studentët<br>- Rruga e tretë është përmes Zyrës së Karrierës, e cila po strukturohet dhe ka marrë një vemendje më të rritur në institucion pas pandemisë, ku me rsistrukturimin e godinës ka zënë një vend të dukshëm në hyrje dhe ka një specialiste të dedikuar në raportet me studentët; |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.3**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve. | Studentët kanë disa rrugë për t'u informuar për përmbajtjen e programit. Fillimisht është ËEB i fakultetit dhe Guida e Fakultetit ku studentët gjejnë informacionin paraprak dhe bazë. Dosja e plotë e programit të studimit është një dokument i formuluar me seriozitet, në të cilin gjendet çdo informacion i nevojshëm në lidhje me programin. Programi përmban 180 kredite, që ndahen mes lëndëve bazë, lëndëve karakterizuese, lëdëve më zgjedhje për të dyja profilet e studimit; praktikën mësimore dhe detyrimin përmbyllës të diplomës. Mësimi organizohet në 6 semestra, çdo |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit | |

| | |
|---|---|
| informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | semestër përmban 30 ECTS dhe zgjat 15 javë.<br><br>Një burim tjetër i rëndësishëm informacioni është silabusi i lëndëve i cili qartëson llojin e lëndës, numrin e krediteve, semestrin në të cilin zhvillohet, mënyrën e vlerësimit të njohurive, detyrimet e lëndës, frekuentimin.<br><br>Bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit, studentët gëzojnë të drejtën të përfundojnë studimin në një afat ligjor që është dyfishi i periudhës së studimit, kuptuar deri në 6 vite nga momenti i nisjes, përjashtim nga ky rregull bëhet në rastin kur student pezullon studimet e tij për një afat të caktuar kohor për rrethana të caktuara në jetën e tij. Departamenti bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit përcakton dhe koordinatorin e programit, i cili në thelbin e veprimtarisë së tij është një ndërlidhës i rëndësishëm i studentit me departamentin dhe gjithë procesin akademik. Gjithashtu, në përputhje me Statutin dhe Rregulloren, Sekretaria mësimore dhe Zyra e Informacionit suportojnë studentët për të gjitha nevojat dhe kërkesat e tyre.<br><br>Funksionalizimi i sistemit të ri të sekretarisë do të shënonin një hap cilësor në raportet e përditshme student-pedagog-sekretari- drejtim. *Mbetet e rëndësishme ndërtimi dhe i një sistemi LMS.*<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. në "Menaxhim Biznesi".*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës. | Nësë flitet për pikat e forta të KU Logos janë cilësia dhe reputacioni i stafit akademik si dhe cilësia e studentëve, për rrjedhojë kanali më i rëndësishëm për punësimin e studentëve mbetet rekomandimi i tyre nga pedagogët, për shkak të netëorkut të tyre. Kjo gjë u diskutua dhe me stafin akademik të Deaprtamentit të Menaxhimit gjatë vizitës në institucion<br><br>Qendra e Karrierës përbën një bërthamë të kontaktit të studentëve me tregun e punës, dhe ekzistojnë të gjitha premisat që ajo të rritet e bëhet më dinamike. Gjithashtu në ËEB, botohen një sërë publikimesh që kanë lidhje me konkurse, intershipe, punësime etj në ndihmë dhe në shërbim të studentëve. Duhet theksuar që studentët e programit Bachelor përfshihen në aktivitete që organizohen nga departamenti dhe fakulteti. |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e | Informacioni në funksion të studentëve vihet në shërbim të studentëve kryesisht përmes kanaleve të mëposhtme të komunikimit:<br><br>- ËEB i KU "Logos" |

| | |
|---|---|
| procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | - Pedagogëve;<br>- koordinatorit të programit;<br>- sekretarisë mësimore.. |
| **Kriteri 5** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet permes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance. | Mësimi online për shkak të pandemisë, krijoj dhe një mënyrë tjetër të komunikimit pedagog-studentë përmes sistemit MS Teams, i cili mundësoi jo vetëm mësimin online, por dhe komunikimin e informacioneve, depozitimin e materialeve të ndryshme didaktike nga pedagogët por dhe upload-imin materialeve, detyrave etj nga studentët.<br>*Shtojca 71..2 Përdorimi i MS Teams* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi. | Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Rregulloren e KU Logos çdo fakultet ka brenda njësisë së administratës, Sekretarinë Mësimore. Sekretaria Mësimore funksionon në bazë të të gjithë akteve ligjore dhe nënligjore, mbi këtë bazë njësia kryesore ka formuluar Rregulloren e Sekretarisë, që në setin e dokumentave të vendosura në platformën e ASCAL vjen si projekt-rregullore. Në Sekretarinë Mësimore mbahen të gjitha statistikat në lidhje me numrin e studentëve: të rregjistruar, të diplomuar, largimet, pezullimet, transferimet, ecuria e studentëve; proces-verbalet e provimeve, rregjistri themeltar, dosjet e çdo studenti sipas udhëzimeve të MAS. |
| **Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | |
| **Kriteri 3.** Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri | Përmes të dhënave të marra nga sekretaria, drejtuesja e departamentit ka hartuar për vitin 2020-2021 një raport analitik të detajuar, ku krahas të tjerave është bërë dhe një analizë e kalueshmërisë për lëndë dhe notës mesatare. Gjatë vizitës në institucion, ekspertët e jashtëm kaluan një kohë dhe në sekretarinë |

| | |
|---|---|
| në diplomimin e tyre. | e programit bachelor. Dosjet e ecurisë së studentëve nga semestri në semestër dhe për cdo vit akademik, rregjistri themeltar dhe çdo informacion tjetër që ju kërkua stafit u vendos në dispozicion. Gjithashtu, shqyrtuam dhe mbajtjen e të gjithë informacionit në mënyrë elektronike në database excel.<br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 4.** Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | Në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë, sekretaria mësimore si pjesë e njësisë së Administratës, ka ndërtuar gjithë sistemin e brendshëm të menaxhimit të informacionit për studentët që nga momenti i rregjistrimit në përputhje me rregullat e MAS, deri në përfundim të studimeve dhe pajisjen me diplomë dhe suplementin e diplomës. Gjatë vizitës në sekretari, dosjet fizike dhe "dosjet elektronike", rregjistrat, proces-verbalet, rregjistri themeltar dhe çdo dokument tjetër që është nën përgjegjësinë e zyrës ishin lehtësisht të verifikueshme dhe mjaft mirë të sistemuara. |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. | Fakulteti, bazuar në udhëzimet e MAS harton raportet vjetore. Raportet vjetore kanë një format standard dhe një nga rubrikat i referohet të dhënave të studentëve për çdo program studimi.<br>Një Raport tjetër i rëndësishëm është dhe analiza vjetore e punës së departamentit, në të cilën gjenden të dhëna mbi kalueshmërinë dhe mesataren e vlerësimit për çdo lëndë të departamentit. Një raport me vlerë në tërësinë e dokumentacionit të paraqitur është ai i gjurmimit të studentëve pas diplomimit, të dhënat e të cilit duhet të shërbëjnë dhe për të përditësuar programin.<br>*Shtojca 19. Syllabuset e lëndëve të programit Bsc në Menaxhim Biznesi.*<br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'*<br>*Shtojca nr 14.3 Plani mësimor i programit të studimit Bsc në Menaxhim Biznesi* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushe t pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi V.5<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.<br><br>**Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | Ligji për Arsimin e Lartë Nr 80/2015 përcakton të drejtën e studentëve për t'u përfaqësuar në një sërë organesh vendimarrëse dhe me rol konsultativ brenda strukturave të universitetit. Në Statut disa nene i dedikohen studentëve.<br><br>Gjithashtu, studentët janë pjesë e:<br><br>- komisionit të sigurimit të standardeve të cilësisë;<br><br>-komisionit të mbarëvajtjes së veprimtarive dhe marrëdhënieve me studentët;<br><br>- komisionit të kurrikulave;<br><br>- komisionit të etikës;<br><br>-grupeve të vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit dhe grupeve të tjera ad hoc qe mund të ngrihen në nivel njësie kryesore apo bazë;<br><br>Një veprimtari e rëndësishme e sanksionuar me Statut janë *Këshillat e Studentëve* të cilat mbrojnë dhe përfaqësojnë interesat e studentëve në të gjitha programet e studimit.<br><br>Mbështetur në Statut, në disa nga rregulloret dhe organet e institucionit sanksionohet e drejta e studentëve për t'u përfaqësuar dhe patur rol në vendimarrje.<br><br>Pjesëmarrja e studentëve në Komisionin e Kurrikulave, në Komisionin e Sigurimit të Standardeve të Cilësisë, në Senat në grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve është mundësi e drejtpërdrejtë për të ndikuar në rishikimin e përmirësimin e programeve,<br><br>Pjesë e rëndësishme e pjesëmarrjes së studentëve në vlerësimin e procesit akademik është dhe zhvillimi i procesit të vlërësimit të lëndës, që krijon mundësinë e analizave të mëtejshme në terma të përmbajtjes së lëndës, por dhe mënyrës së zhvillimit të saj nga pedagogu, si dhe në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulës.<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim* |

| | |
|---|---|
| | *Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 3.** Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.<br><br>**Kriteri 4.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to. | Programi i studimit është hartuar duke respektuar VKM 41, 24.01.2018 "Për elementët e programit të studimit të ofruara nga IAL-të".<br><br>Mbi këtë bazë, programi ka 180 kredite, zhvillohet në 6 semestra, çdo semestër ka 30 ECTS. Njohja e studimeve të plota dhe të pjesshme bëhet përmes një procedure e cila bazohet në dhe në Rregulloren e programit te studimit, drejtohet dhe administrohet nga departamenti dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit. Mobiliteti i studentëve si një nga benefitet më të mëdha të Procesit të Bolonjës, gjen zbatim plotësisht në KU Logos, në lëvizjen e studentëve nga një universitet në tjetër brenda dhe jashtë vendit, ashtu sikurse në njohjen e krediteve për programet e dyta të studimit, apo në programe të përafërta brenda të njëjtës fushë studimi.<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 5.** Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | Bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit studentët gëzojnë të drejtën e ankimimit të rezultatit pasi kanë dalë vlerësimi. Gjatë vizitës në institucion studentët shprehen se mundësia ekziston, gjatë mësimit online për shkak të komunikimit përmes platformës TEAMS ka qenë shumë më e thjeshtë rishikimi, reflektimi mbi vlerësimin e bërë nga pedagogu.<br><br>Në mësimin normal, vlerësimet paraqiten në këndin e njoftimeve dhe nëse studentët nuk arrijnë ta shohin në kohë, ata humbasin afatin e përcaktuar nga rregullorja, *prandaj bëhet i domosdoshëm digjitalizimi i gjithë komunikimi me studentët.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**Standardi V.6**

**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët**

<table>
<tr><th>Kriteret</th><th>Vlerësimi i ekspertëve</th></tr>
<tr><td>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</td><td>Në përputhje me Statutin, në njësinë kryesore dhe atë bazë funksionojnë një sërë zyrash të cilat mbështesin studentët në plotësimin e një tërësie procesesh dhe aktivitetesh të domosdoshme për procesimin gjatë studimeve master.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</td><td rowspan="3">Brenda fakultetit, Zyra e Informimit të Studentëve, Sekretaria Mësimore, Zyra e Financës, Zyra IT, koordinatori i programit drejtuesi i departamentit dhe stafi i tij ndihmojnë studentët për qartësimin e elementëve të ndryshëm në procesin nga rregjistrimi i tyre deri në marrjen e diplomës.<br><br>Pedagogët gjithashtu komunikojnë me studentët dhe gjatë periudhës së zhvillimit të mësimit online, përmes sistemit MS Teams ata kanë ndërvepruar me studentët duke dërguar materialet, bërë mësimin me rregjistrim dhe duke ju përgjigjur kërkesave të tyre përmes platformës. Në këtë periudhë në shërbim të studnetëve u vendosën udhëzues dhe u hartuan rregullore të posaçme.<br><br>Një nga kanalet efektive të komunikimit me studentët është ËEB i fakultetit, në të cilin ata informohen për elementë të shumtë të procesit akademik, por dhe për shumë mundësi e procese të tjera nga konkurset, konferencat, mundësitë për intership, punësim, bursa ersamus, etj.<br><br>Në takimin në institucion me stafin e angazhuar në program, evidentuam që pedagogët e departamentit për shkak të reputacionit të tyre janë këshilluesit më profesionistë të karrierës së studentëve të tyre dhe kjo përbën një vlerë të shtuar për institucionin dhe studentët, në atë çka ata mund të përfitojnë gjatë viteve të studimit.<br><br>Zyra e Karrierës është e alokuar në hollin hyrës, duke i dhënë mundësinë studentëve të aksesojnë dhe ndërveprojmë me specialisten e saj.<br><br>Zyra i përgjigjet duke komunikuar me subjektet që janë pjesë e listës së marrëveshjeve me KU “Logos”<br><br>Sugjerojmë që kjo listë të shtohet dhe pasurohet veçanërisht me subjekte të botës së biznesit dhe marrëveshjet të reflektojnë dinamikat që tregu i punës ka sot.<br><br>Zyra e Karrierës dhe Departamenti mbledhin në vijueshmëri informacione mbi studentët e diplumar, punësimin e tyre, megjithatë ky proces ka vend ende për përmirësim.<br><br>Sugjerim tjetër është organizimi i aktiviteteve të Rrjetit Alumni, i</td></tr>
<tr><td>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</td></tr>
</table>

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *cili në rastin e programit që akreditohet do të ishte dhe një histori suksesi.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

**Standardi VI.1**

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisët**

| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.<br><br>**Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.<br><br>**Kriteri 3.** Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të | Për të siguruar cilësinë KU 'Logos' ka krijuar struktura si Komisioni i Përhershëm i Garantimit dhe Sigurimit të Cilësisë së Institucionit dhe Programeve të Studimit si dhe Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.<br><br>Departamenti përpilon në mënyrë periodike raporte për ecurine e punës së tij në bashkëpunim me NJSBC. Në Analizën Vjetore të Punës Mësimore, Kërkimore dhe Shkencore Departamentit të Menaxhimit për vitin akademik 2020-2021 gjejmë të analizuar: ngarkesën mësimore dhe një sërë sugjerimesh për përmirësimin e procesit mësimor; analizën e rezultateve të studentëve dhe të mësimdhënies, e cila vjen e detajuar sipas programeve të studimit dhe lëndëve; kërkimin shkencor me disa rubrika nga botimet, në mobilitetet, pjesëmarrjen në projekte ndërkombëtare dhe lokale.<br><br>Për të bashkërenduar në sigurimin e cilësisë KU 'Logos' ka krijuar një sërë strukturash mbështetëse si Zyra e Çështjeve Studentore, Zyra e shërbimeve e të tjera të cilat mund të aksesohen dhe në faqen zyrtare të institucionit.<br><br>GVJ bazuar në RVB dhe në vizitën dhe takimet e zhvilluara në institucion identifikoi që vlerësimi dhe monitorimi i cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies bazohen në statutin dhe rregulloret e institucionit. Departamenti ndjek rregullisht ecurinë e procesit mësimor dhe monitoron rregullisht aftësitë mësimdhënese të personelit akademik dhe pedagogjik.Vlerësimi i stafit akademik për mësimdhënien synojnë të stimulojne dhe inkurajojnë pedagogët që aplikojnë metoda të reja mësimdhënie, dhe ky vlerëim nuk është |

| | |
|---|---|
| tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. | i diferencuar. |
| **Kriteri 4.** Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit. | Monitorimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të stafit akademik kryhet në mënyrë periodike nga departamenti dhe fakulteti përkatës në bashkërendim me NJSBC nëpërmjet vlerësimit të performancës së tyre dhe nëpërmjet rezultateve të pyetësoreve të plotësuara nga studentët. Vlerësimi i stafit akademik gjithashtu bëhet për cdo akademik nga përgjegjësi i departamentit.<br>*Shtojca 13. Politika për Sigurimin e Cilësisë*<br>*Shtojca 8. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë*<br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi VI.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë. | Për të siguruar cilësinë KU 'Logos' ka krijuar struktura si Komisioni i Përhershëm i Garantimit dhe Sigurimit të Cilësisë së Institucionit dhe Programeve të Studimit si dhe Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.<br>Kjo njësi shërben për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë. Megjithatë sipas RVB-së, në zbatim të akteve rregullative institucionale përsëri pesha bie mbi drejtuesit e njësive bazë dhe kryesore për të marrë masa organizative dhe monitoruese për procesin mësimor dhe kërkimor, por është anashkaluar evidentimi i përgjegjësive konkrete të NJSBC e cila është Njësia e Posaçme e ngritur nga IAL për të monitoruar, shqyrtuar, mbikëqyrur dhe rishikur programin e studimit. |
| **Kriteri 2.** Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë. | |
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe | Në DVV gjenden nga GVJ evidenca për të dokumentuar punën e NJSBC për çdo fund viti akademik për proceset e ndryshme të planveprimit edhe raportin përmbledhës të gjithë aktivitetit vjetor, si dhe sygjerimet e kësaj njësie për çdo aktivitet të vlerësuar lidhur |

| | |
|---|---|
| mbarëvajtjen e programeve të studimeve. | me programin e studimit.<br><br>Gjatë vizitës në IAL, ekspertët pyetën përfaqësuesit e NJSBC për:<br><br>a) Shpeshtësinë e raportimit në informimin e drejtuesve të njësive bazë dhe përmes tyre të gjithë stafin mbi rezultatet e monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performances së stafit akademik.<br><br>Përgjigja nga NJSBC ishte se përpilohej një raport vjetor, nga drejtuesi i NJSBC.<br><br>U bëmë me dije se shpeshtësia e dhënies së opinioneve të tyre ishte edhe javore pasi. Gjithashtu, në pyetësor nuk ka pyetje për të vlerësuar cilësinë e punës së stafit administrativ nga studentët, për të cilën sugjerojmë që ta marrin në konsideratë. Gjithashtu, informacioni i përftuar nga këta instrumenta kontrolli pas përpunimit përdoret në mbështetje të procesit të vlerësimit të performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik nga ana e njësive përgjegjëse.<br><br>Në përfundim, GVJ rekomandon:<br><br>***NJSBC të mbaj evidenca për të reflektuar në raporte të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit nëpërmjet analizave për zbatimin e detyrave apo masave për adresimin e gjetjeve, mangësive për përmirësimin në vijim të cilësisë.***<br><br>*Shtojca 13. Politika për Sigurimin e Cilësisë*<br><br>*Shtojca 8. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë*<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br><br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br><br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 4.** Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. | |
| **Kriteri 5.** Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë. | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi VI.3**<br><br>**Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Vlerësimi i brendshëm i programit të | Ku Logos ka përgjegjësinë t'i ofrojë shoqërisë shqiptare një cilësi të lartë të programeve mësimore, të tregojë se po bën përpjekjet e |

| | |
|---|---|
| studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike. | mundshme për të përdorur në mënyrë efektive dhe efikase tarifat e studimit nga studentët e tij, dhe të sigurojë mbarëvajtjen cilësore të këtij programi studimi jo vetëm deri në diplomimin e studentëve por edhe daljen e tyre në tregun e punës apo sigurimin e trajnimit të vijueshëm të tyre edhe pas diplomimit.<br><br>Sipas RVB-së, NJSBC raporton tregues, opinione dhe sugjerime që vijnë nga vlerësimi i pedagogut dhe lëndës përmes pyetësorëve, sondazheve, e fokus grupeve të studentëve të të gjitha viteve dhe programeve dhe kontakteve të vazhdueshme me ata.<br><br>Në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdoren metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies: analizat vjetore të veprimtarisë mësimore-kërkimore në rang departamenti, dhe më pas në nivel fakulteti të cilat pasqyrohen në raportet përkatëse ku analizohen të gjithë elementët matës të cilësisë; dekanati me strukturat e tij ushtrojnë kontrolle mbi kryerjen e procesit mësimor përgjegjësi i departamentit në bashkëpunim me përgjegjësit e grupeve mësimore-kërkimore monitorojnë procesin e mësimit, realizimin e programit mësimor, veprimtarinë kërkimore-shkencore, realizimin e seancave laboratorike të studentëve, procesin e provimeve, performanca e personelit akademik.<br><br>Rol të vecantë luan edhe vlerësimi për programet e studimit nga palë të treta të fushës përkatese nga sektori publik dhe privat.<br><br>GVJ konstatoi në raport se kryhen sondazhe apo intervista me aktorë të tregut të punës për punësimin e studentëve të këtij programi pavarsisht se edhe sipas manualit të NJSBC i jepet rol i vecantë vlerësimit të programit të studimit nga palë të treta të fushës përkatese (nga sektori publik dhe privat).<br><br>Gjithashtu, një instrument i rëndësishëm për të tërhequr mendim dhe vlerësim mbi programin e studimit dhe sa i përgjigjet ai tregut të punës janë dhe studimet e tregut të punës të organizuara nga Departamenti i Menaxhimit për këtë program.<br><br>*GVJ i këshillon IAL-së që përveç metodave që ai aplikon duhet të përdorë edhe metoda dhe instrumenta të tjera të cilat ndihmojnë vlerësimin dhe ndërtimin e qëndrueshëm të cilësisë së programit të studimit, të tilla si sondazhe e intervista me punëdhënës për studentët e këtij programi studimi.*<br><br>*Shtojca 13. Politika për Sigurimin e Cilësisë*<br><br>*Shtojca 8. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë*<br><br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.* |
| **Kriteri 2.** Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit. | |
| **Kriteri 3.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera. | |
| **Kriteri 4.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. | *Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi VI.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | Referuar RVB nuk shprehet qartë lidhur me këtë standard, por referuar Evidencave të depozituara në AMS mund të evidentojmë se Senati Akademik është siguruar që përmes miratimit të SBC Rregullores së Përgjithshme të NJSBC te përfshijë aktorë të brendshëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë. së programit të studimit përmes citimit në nenin 4 dhe 5 të Manualit të SBC ku përcaktohet ngritja e GVB dhe në përbërje të tyre të ketë përfaqësues të studentëve, stafit akademik dhe atij ndihmësakademik apo administrativë.<br>GVJ në Rregulloren e Përgjithshme të NJSBC konstaton se:<br>• Eshtë përcaktuar përbërja e NJSBC e cila nuk ka asnjë përfaqësim nga aktorë të jashtëm të interesuar të tillë si punëdhënës apo ekspertë të jashtëm të fushës, etj.<br>Siç rezultoi nga evidencat e vëna në dispozicion për vlerësimin e jashtëm, përveç studentëve, aktorët bazë në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit janë edhe anëtarët e njësisë bazë (Departamenti i Menaxhimit) dhe njësia kryesore me strukturat e tij. Roli i tyre është i mirë përcaktuar në aktet rregullatore institucionale në kuadër të përmirësimit të vazhduar të cilësisë në KU Logos. |
| **Kriteri 2.** Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. | |
| **Kriteri 3.** Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së | |

| | |
|---|---|
| programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit. | Gjithashtu, GVJ konstaton se nuk ka evidenca (dokumenta) që tregojnë përfshirjen më të gjerë të bashkëpunëtorëve dhe/ose ekspertëve të jashtëm të cilët mund të japin ekspertizë të vyer në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj dhe çfarë janë reflektuar në realitet nëse ka pasë të tilla takime.<br>*(Ligji i Arsimit të Lartë (80-2015 i datës 22.07.2015);*<br>*Shtojca 13. Politika për Sigurimin e Cilësisë*<br>*Shtojca 8. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë*<br>*Shtojca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi.*<br>*Shtojca 6. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit*<br>*Shtojca 5. Rregullore e Përgjithshme e KU 'Logos'* |
| **Kriteri 4.** Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. | |
| **Kriteri 5.** Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi VI.5** | |
|---|---|
| **Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |

<table>
<tr><td>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</td><td>GVJ konstaton se në këtë standard ashtu si edhe në disa të tjera të kësaj fushe vlerësimi në RVB nuk janë dhënë përgjigje për atë çfarë kërkojnë kriteret por ka përsëritje të përgjigjeve, si edhe ka mungesë të referencave dhe evidencave. Të gjitha sa më sipër e vendosin në vështirësi vlerësimin nga ana e GVJ-së.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</td><td>Bazuar ne RVB, Fakulteti përgatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi cilësinë, i cili u vihet në dispozicion pretendentëve (drejtues, pedagogë, të tjerë të interesuar).</td></tr>
<tr><td>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</td><td>Tërheqja e mendimit të studentëve ka shërbyer për të nxjerrë konkluzione mbi cilësinë e punës së pedagogëve dhe sipas GVB në ndonjë rast ka pasë edhe marrjen e masave konkrete ndaj pedagogëve të ndryshëm. Ndërsa NJSBC nuk na konfirmoi ndonjë gjetje materiale të marrë nga studentët dhe si rrjedhim nuk ka pasë asnjë masë të marrë.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</td><td rowspan="2">Sipas RVB konstatohen disa rast/gjetje të konsideruara si problemet më kryesore të cilat kanë qënë të lidhura me literaturën e rekomanduar, shfrytëzimin e orës së mësimit, cilësinë në shpjegim dhe kontrollin e dijeve, etj. Si edhe për ndërgjegjësimin e personelit dhe studentëve është arritur përmes një larmie formash, nga trajnimi deri te rifreskimi i njohurive mbi standardet dhe kërkesat e veçanta për cilësi.<br><br>Një tjetër kërkesë e një kriteri në këtë standard është për publikimin e rezultateve të vlerësimeve të programit të studimit. GVJ gjatë vlerësimit të RVB, ëebsite të IAL-së, si edhe evidencave të depozituara në AMS nuk konstaton që IAL të ketë plotësuar kërkesën e këtij kriteri duke siguruar transparencë për publikimin edhe në faqen ëeb të KU Logos të Raporteve për analizat e rezultateve të pyetësorëve nga anketimi i studentëve. Në këtë mënyrë nuk sigurohet transparenca për studentët dhe të gjithë palët e interesuara. Në përfundim, GVJ i sugjeron IAL-së, të merren masat për:<br><br>Publikim të rezultateve të vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</td></tr>
</table>

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

**<u>Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë *Bachelor* në "Menaxhim Biznesi" të ofruar nga Kolegji Universitar "LOGOS".</u>**

***<u>Pika të forta</u>***

1. Programi Bachelor ne Menaxhim Biznesi është përmirësuar bazuar në rekomandimet e mëparshme duke ofruar në këtë mënyrë lëndë të cilat përshtasin studentin me kërkesat e tregut të punës dhe garantojnë fitimin e njohurive të përgjithëshme dhe të karakterit professional.
2. Departamentet e Fakultetit Ekonomik bashkëpunojnë ngushtësisht me njëra tjetrën për arritjen e objektivave të tyre në lidhje me fushat akademike dhe kërkimore.
3. Për të bashkërenduar në sigurimin e cilësisë KU 'Logos' ka krijuar një sërë strukturash mbështetëse si Zyra e Cështjeve Studentore, Zyra e shërbimeve e të tjera të cilat mund të aksesohen dhe në faqen zyrtare të institucionit.
4. KU 'Logos' ka bërë ndryshimet e rekomanduara më parë në lidhje me planin mësimore duke përafruar në këtë mënyrë programin me programe të ngjashme ndërkombëtare.
5. GVJ konstaton se studentët përfshihen në vlerësimin e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve nëpërmjet dhe pyetësorëve, si edhe paraqitjes së ankesave kundrejt pakënaqësive të tyre lidhur me format e vlerësimit.
6. Fakulteti dhe Departamenti përgjegjës për këtë program studimi përdorin mënyra për vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies.
7. Fondi i bibliotekës, në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, pasurohet në mënyrë të vazhdueshme, saj edhe fushatës 'Një libër më shumë për bibliotekën e Logosit'.

***<u>Pika të dobeta</u>***

1. Duhen ndermarre inisiativa për të krijuar procese të qëndrueshme bashkëpunimi dhe formalizim të marrëdhënieve universitet/fakultet/department- industri. **(Standardi I.2 / kriteri 4)**

***Rekomandime***

1. Rekomandohet rritja e bashkëpunimeve në kuadër të programit ERASMUS, të cilat do të mundësonin lëvizjen e studentëve dhe stafit akademik.
2. Nevojitet një sistem funksional bashkëpunimi industri – universitet, qw vjen nga forcimi i marrëdhënieve me sipërmarrjen dhe departamentin.
3. Rekomandojmë një përqasje me proaktive të departamentit në lidhje me praktikën e punës së studentëve, punën kërkimore dhe lidhjen me TIK. Një forcim i lidhjes me bizneset do të mundësonte praktikat profesionale, dhe një rritje të lidhjes me Teknologjinë e informacionit do të mundësonte rritjen e aftësive digjitale të studentëve.
4. Grupi i RVJ rekomandon që të rritet numri i trajnimeve profesionale dhe të bëhet ndjekja e mëtejshme e studentëve në tregun e punës.

**Assessment conclusions for the "Navigation and Maritime Management" Bachelor study program offered by "LOGOS" University College.**

***Strong points***

1. The Bachelor's program in Business Management has been improved based on previous recommendations, offering courses that align students with the demands of the job market and ensure the acquisition of general and professional knowledge.
2. Departments of the Faculty of Economics closely collaborate with each other to achieve their objectives in academic and research fields.
3. To coordinate quality assurance, KU 'Logos' has established supportive structures such as the Student Affairs Office, Service Office, accessible on the institution's official website.
4. KU 'Logos' has implemented recommended changes to the curriculum, aligning the program with similar international programs.
5. GVJ notes that students are involved in evaluating teaching methods, assessing knowledge through surveys, and expressing complaints about assessment formats.
6. The Faculty and Department responsible for this study program use methods for continuous assessment and improvement of teaching quality.
7. The library fund, in Albanian and foreign languages, continuously enriches, including the campaign 'One more book for the Logos library'.

***Weak points***

1. A functional industry-university cooperation system is needed, stemming from strengthening relations with entrepreneurship and the department. (Standard I.2/ Criter 4)

***Recommendations***

2. Increasing collaborations within the ERASMUS program is recommended, which would enable the mobility of students and academic staff.
3. A functional industry-university cooperation system is needed, stemming from strengthening relations with entrepreneurship and the department.
4. We recommend a proactive approach by the department regarding student internships, research work, and connection with ICT. Strengthening ties with businesses would enable professional internships, and increasing links with Information Technology would facilitate the enhancement of students' digital skills.
5. The RVJ group recommends increasing the number of professional training sessions and further monitoring students in the job market.

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | | X | |
| II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | | | X |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | X |